



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
BASHKIA SHKODËR
NJESIA E PROKURIMIT

Nr. 20613 Prot

Shkodër, më 29.12.2023

KONTRATË SHËRBIMI NR.2
REF-69846-05-19-2023

SHERBIMI I PASTRIMIT ZONA "PERENDIMORE "

BASHKIA SHKODËR
DHJETOR 2023





KONTRATË SHËRBIMI
REF-69846-05-19-2023

“SHERBIMI I PASTRIMIT ZONA “PERENDIMORE”


E lidhur sot me datë ____/____/2023, midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkoder, e përfaqësuar nga **Z.Benet Beci** në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Shkoder i përfaqësuar ne kete kontrate me Vendim Delegimi nr.325 date 02.10.2023 nga **Z.Onid Bejleri** në cilësinë e Zv/Kryetarit të Bashkisë Shkoder që në vijim do të quhet **Autoriteti Kontraktor**.

Dhe Operatorit ekonomik **“Rej”sh.p.k** e regjistruar me regjistrim fillestar me nr.:CN-005341-09-07 me leje profesionale te shoqerise kodi III.2.B LN-1851-07-2016 date 21.02.2016 me vlefshmeri te lejes pa afat, leshuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomise me seli te shoqerise: Tirane , Zogu i Zi, Qatar Center, kati 2, me NUIS J93711608Q, e perfaqesuar nga Perfaqesuesi Ligjor i shoqerise **Z.Luan Kapri** me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe kompetencë të plotë për të përfaqësuar shoqerine, në të gjitha marredhëniet që burojnë prej kësaj kontrate me autoritetin Kontraktor, Bashkia Shkodër për realizimin e objektit të kontratës. Në vijim do të quhet **“Kontraktuesi**

Neni 1

Baza ligjore

- ✓ Kodi Civil, miratuar me ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994, të ndryshuar,
- ✓ Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”,
- ✓ VKM nr. 285, dt. 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar
- ✓ Ligji nr. 48/2014 ”Per pagesat e vonuara ne detyrimet kontraktore e tregtare” i ndryshuar.
- ✓ Ligji nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore” i ndryshuar
- ✓ VKM nr. 175, datë 19.01.2011 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve”
- ✓ Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar
- ✓ VKM nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve urbane”
- ✓ Ligji nr. 8094, datë 21.03.1996 “për largimin publik të mbeturinave”
- ✓ Udhëzimit nr.6 date 16.01.2018“Per perdorimin e marreveshjes kuader dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike“ i ndryshuar.
- ✓ Marreveshja kuader nr.6850/13 Date 29.06.2023





Neni 2 Përkufizime

2.1 Kontrata

- “Kontratë” do të thotë marreveshja e shkruar e lidhur midis Blerësit Publik dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- “Kontratë”, nënkupton marrëveshjen e shkruar, e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Operatorit Ekonomik. Ajo përbëhet nga:
- “Çmim kontratë” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.
- “Termat e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.
- “Specifikimet teknike” siç janë paraqitur në dokumentet e tenderit dhe në Kontratë dhe çdo shtesë apo modifikim i Specifikimeve në përputhje me Kontratën. Ky dokument specifikon Shërbimin.
- “Preventivi” quhen vëllimet e punës të plotësuara me cmime, pjesë perberese e kontratës.

2.2 Palët dhe personat

- “Palë” nënkupton Autoriteti Kontraktor ose Kontraktuesi, sipas kontekstit.
- “Autoritet Kontraktor”, nënkupton Bashkinë Shkodër, një entitet shtetëror i autorizuar me ligj për të kryer procedurat e prokurimit, e cila përcakton kritere dhe kërkesa për përmbushjen e planifikimit të saj për realizimin e blerjes së shërbimeve dhe të mirave në interes të interesit publik.
- “Kontraktuesi” nënkupton personin(at) të quajtur Kontraktues të pranuar nga Autoriteti Kontraktor dhe pasardhësi juridik me këtë titull për këtë person.
- “Monitorues i Shërbimit” nënkupton personin kompetent/strukturen të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkodër, i cili është përgjegjës për supervizimin e performancës së Shërbimit të pastrimit dhe që asiston administrimin e Kontratës.
- “Drejtuesi Teknik i shërbimit të pastrimit” nënkupton personin e miratuar nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Shkodër si përfaqësues i Kontraktuesit, i cili është përgjegjës për performancën e shërbimit të pastrimit sipas kontratës.

2.3 Datat, Periudhat dhe Përmbushja

- “Data e Fillimit” nënkupton datën e përcaktuar si e tillë për fillimin e Shërbimit.
- “Koha e përmbushjes” nënkupton kohën për përmbushjen e Shërbimeve.
- “Ditë” nënkupton një ditë kalendarike dhe “vit” nënkupton 365 ditë.





2.4 Paratë dhe Pagesat

- **“Vlera totale e kontratës”**, nënkupton vlerën e pranuar nga Autoriteti Kontraktor për zbatimin dhe përmbushjen e Shërbimit.
- **“Çmim kontratë”**, nënkupton vlerën për t’u paguar nga Autoriteti Kontraktor për zbatimin dhe përmbushje nga ana e Kontraktuesit të shërbimeve dhe përmbushjes së të gjitha detyrimeve kontraktuale dhe ligjore të lidhura me këtë Kontratë.
- **“Çertifikata e pagesës – situacioni”**, nënkupton dokumentin e evidencave faktike të shërbimit të kryer, duke përfshirë situacionet e shërbimit të realizuara dhe të konfirmuara nga Drejtoria e Shërbimeve Publike në përputhje me zërat e specifikuar në preventiv, dhe të certifikuara me procesverbalet ditore, të hartuara nga përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor, Bashkia Shkodër.
- **“Procesverbalet – Deklaratat”**, nënkupton dokumentet kontraktuale të hartuara nga përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor, Bashkia Shkodër, për përshkrimin e gjetjeve të verifikuara gjatë kontrolleve të ushtruara në terren, të cilat kanë qëllim të pasqyrojnë dhe certifikojnë Shërbimin e kryer, pakryer dhe në proces, në mënyrë që të përcaktohen përgjegjësitë kontraktuale dhe të përlogariten penalitetet e mundshme dhe gjobat për Kontraktuesin në përputhje me termat e kësaj Kontratë. Procesverbalet do të pershkruajnë gjithashtu problematikat e hasura gjatë inspektimeve.
- **“Procesverbalet”** do të përdoren si mbështetje për të certifikuar pagesën për Kontraktuesin.

2.5 Shërbimet dhe Përkufizime të tjera

- **“Shërbimet – Objekti i Kontratës”** nënkupton të gjitha Shërbimet që do të ofrojnë Kontraktuesi sipas kriterëve dhe termave të përcaktuara në këtë Kontratë.
- **“Mbetje të ngurta Urbane”** nënkupton të gjitha materialet organike dhe inorganike që vijnë nga konsumi i Konsumatoreve.
- **“Edukim publik ambiental”**, nënkupton përpjekjet për ngritjen dhe përmirësimin e njohurive të konsumatorëve apo banorëve të qytetit me qëllim përpunimin, transportin, largimin ose aspektet e tjera që lidhen me mbajtjen pastër të ambientit.
- **“Zonë e kontratës”** quhet hapësira e territorit brenda kufijve të përcaktuar në hartë e mbi të cilët ushtron juridiksion e kompetencë institucioni Bashkia Shkodër. Kjo hartë është pjesë përbërëse e kësaj kontratë, ku Kontraktuesi si është i detyruar të sigurojë përmbushjen e shërbimeve të pastrimit, grumbullimit, transportit dhe depozitimit të mbeturinave dhe hedhurinave të konsumatorëve ekzistues, si dhe konsumatorëve të tjerë që mund të shtohen gjatë kohëzgjatjes së kontratës.
- **“Mbeturina të rrezikshme”**, nënkuptojnë mbeturinat e dëmshme ose toksike, që rrezikojnë shëndetin dhe jetën e personit, sjellin pasoja ekologjike dhe administrohen me ligje të veçanta".





- "Pikë grumbullimi i mbeturinave (PGM)" nënkupton hapësirën në të cilën do të kryhet shërbimi i heqjes së mbeturinave nga kontenierët dhe zona përreth kontenierëve, siç është përcaktuar në hartë dhe në specifikimet teknike bashkëngjitur dokumenteve të tenderit.

Neni 3

Objekti i kontratës

- 3.1 Objekt i kësaj kontratë është shërbimi me objekt: "Shërbimi i pastrimit zona "Perendimore" në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të dhëna në dokumentat e tenderit dhe që Kontraktuesi "Rej" sh.p.k pranon t'i realizojë sipas ofertës së ofruar dhe pranuar si fituese në procedurën e prokurimit. Kontraktuesi pranon të gjitha termat e procedurës së prokurimit me firmosjen e kësaj Kontratë.

Neni 4

Afati i kontratës – Data Fillimit

- 4.1. Kontrata nr.2 do të realizohet nga data **01.01.2024 deri me date 31.12.2024** në zbatim të marrëveshja kuader nr.6850/13 date 29.06.2023 me afat 36(tridhjetë e gjashtë) mujor

Neni 5

Vlera e kontratës

- 5.1 Kontraktuesi merr përsiper të kryejë të gjitha shërbimet tek Autoriteti Kontraktor sipas objektit të lartpërmendur në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të dhëna në dokumentat e tenderit, kundrejt një vlere prej **31,708,090** (Tridhjetë e njemilion e shtateqind e tetemije e nentedhjetë) leke pa tvsh dhe **38,049,708** (Tridhjetë e tetemilion e dyzet e nentemije e shtateqind e tete) lekë me tvsh
- 5.2 Financimi realizohet nga Buxheti i Bashkise së Shkodrës".
- 5.3 Çmimet e përfshira në Kontratë, nuk duhet të ndryshojnë nga çmimet e ofruar nga Kontraktuesi në ofertën e tij fillestare.
- 5.4 Autoriteti i Kontraktor rezervon te drejten e rishikimit te volumeve te sherbimit,objekt i kontrates ne rast te ndryshimit te politikave te institucionit,Autoritetit Kontraktor,lidhur me ofrimin e sherbimit te pastrimit .
- 5.5 Çmimet për njësi janë përcaktuar në Formularin e Cmimit të Ofertës si me poshte:

NR	Analizë	Lloji i Sherbimit	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	A	Zona 1				
2	VKM	Grumbullimi dhe transporti i Mbetjeve Urbane.	Ton	3,090	3,500.00	10,815,000.00
3	VKM	Menaxhim dhe mirembajtje e konteniereve	copë	359	7,000.00	2,513,000.00
4	VKB	Depozitim I mbetjeve urbane ne landfillin e Bushatit	Ton	3,090	863.00	2,666,670.00



5	VKB	Diference shtese e rritjes te depozitimit te mbetjeve ne lendfillin e Bushatit.	Ton	3,090	637.00	1,968,330.00
6	An-1	Dezinfektim i PGM've	Kg	2,415	30.00	72,450.00
7		Shuma A pa TVSH				18,035,450.00
8	B	Zona 2				
9	VKM	Grumbullimi dhe transporti i Mbetjeve Urbane.	Ton	932	3,500.00	3,262,000.00
10	VKM	Menaxhimim dhe mirembajtje kazanesh	copë	125	7,000.00	875,000.00
11	VKB	Depozitim I mbetjeve urbane ne landfillin e Bushatit	Ton	932	863.00	804,316.00
12	VKB	Diference shtese e rritjes te depozitimit te mbetjeve ne lendfillin e Bushatit.	Ton	932	637.00	593,684.00
13	An-1	Dezinfektim I PGM've	Kg	1,200	30.00	36,000.00
14		Shuma B pa TVSH				5,571,000.00
15	C	Zona 3				
16	VKM	Grumbullimi dhe transporti i Mbetjeve Urbane.	Ton	924	3,500.00	3,234,000.00
17	VKM	Blerje qese	copë	17,594	10.00	175,940.00
18	VKB	Depozitim I mbetjeve urbane ne landfillin e Bushatit	Ton	924	863.00	797,412.00
19	VKB	Diference shtese e rritjes te depozitimit te mbetjeve ne lendfillin e Bushatit.	Ton	924	637.00	588,588.00
20		Shuma C pa TVSH				4,795,940.00
21	D	Procese te tjera ne sherbim te pastrimit.				
22	An-2	Punetorë të mirmbajtjes të zonës të plazhit /rërës para fillimit të sezonit turistik, dhe mbas mbylljes të sezonit për 21 ditë (pesë punëtorë)	ditë	21	7,500.00	157,500.00
23	An-3	Fshirje manuale (dy punëtorë)	m2	572,000	0.60	343,200.00
24	An-4	Mirembajtja e PGM've per 110 dite sezoni (pesë punëtorë)	PGM	8800	93.75	825,000.00
25	An-5	Punetorë mirmbajtje e zonës të rërës gjatë sezonit për 110 ditë (katër punëtorë)	dite	110	6,000.00	660,000.00



26	An-6	Mirembajtja e 4 tualeteve publike ne zonen e plazhit Velipoje (8 punetore)	dite	110	12,000.00	1,320,000.00
27		ShumaD pa TVSH				3,305,700.00
28		TOTALI PA TVSH	lekë			31,708,090.00
29		TVSH	lekë			6,341,618.00
30		TOTALI ME TVSH	lekë			38,049,708.00

Neni 6 Qëllimi

- 6.1 Kushtet e përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e shërbimeve të prokuruarra me anë të procedurës së hapur.
- 6.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë, parashikon së dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj Kontratë.
- 6.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik, janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i vetëm disa prej dispozitave këtu, nuk mohon në asnjë rast zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e Palëve.
- 6.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 6.5 Kushtet e kontratës përfshijnë, gjithashtu, Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast së ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të prevalojnë mbi KPK.

Neni 7

Gjuha e kontratës

- 7.1 Gjuha e kontratës është gjuha Shqip.

Neni 8

Hartimi i Kontratës

- 8.1 Shpallja e fituesit do të shërbejë për hartimin e Kontratës midis Palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në Dokumentat e Tenderit.
- 8.2 Ekzistenca e Kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumenteve të Kontratës duke trupëzuar të gjitha marrëveshjet midis Palëve si dhe dokumenteve të listuara në Nenin 2.

Neni 9

Praktikat Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Proçesverbaleve

- 9.1 Autortiteti Kontraktues Bashkia Shkodër, mund t'i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme Kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive.



Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkuara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.

- 9.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 9.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues Bashkinë Shkodër, të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues Bashkia Shkodër.

Neni 10

Informacioni konfidencial

- 10.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga Pala tjetër në lidhje me Kontratën.

Neni 11


Prona intelektuale


- 11.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në Kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë Kontratës do të bëhen pronësi e Autoritetit Kontraktues Bashkisë Shkodër, i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 11.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në Kontratë, Kontraktuesi, pas përmbushjes të Kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë Kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me Kontratën pa autorizimin paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues Bashkia Shkodër.
- 11.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktues, Bashkinë Shkodër, nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas Kontratës.
- 11.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoriteti Kontraktues Bashkisë Shkodër në lidhje më ndonjë shkelje të pronës intelektuale, të shkaktuar nga zbatimi i Kontratës ose nga përdorimi i shërbimeve të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktues Bashkisë Shkodër, të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 12

Detyrimet e përgjithshme të kontraktuesit

- 12.1 Kontraktuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushi të gjithat detyrimet siç përcaktohet në këto kushte dhe në Specifikimet Teknike, Specifikimet teknike shërbimi i pastrimit për Bashkinë Shkodër Zona Perendimore me të gjitha përpjekjet, efçente dhe qasje ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuar në përgjithësi.



- 
- 12.2 Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta pune.
- 12.3 Nëse Kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Autoriteti Kontraktues Bashkise Shkodër, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes së mire të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesi dhe ruajë gjithmonë interesin publik.
- 12.4 Nëse Kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në marrdhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashtë kompetencës së tij në përfaqësimin e Autoritetit Kontraktues Bashkise Shkodër .

Neni 13

Detyrimet e veçanta të kontraktuesit

- 13.1 Kontraktuesi pas nënshkrimit të Kontratës ka për detyrë të kryejë Shërbimin e pastrimit në zonën e përcaktuar në Kontratë. Këto shërbime kryhen bazuar e sipas zërave të shërbimit të përcaktuar në Preventiv dhe në përputhje me "Specifikimet teknike", si dhe në propozimet teknike të paraqitura nga Kontraktuesi në ofertën e tij dhe të pranuar nga Autoriteti Kontraktues.
- 13.2 Kontraktuesi është i detyruar që brenda datës së përcaktuar në kontratë për fillimin e kryerjes së shërbimeve të paraqesë të gjitha mjetet, makineritë dhe pajisjet e listuara në "Specifikimet Teknike".
- 13.3 Në rast se mjetet, makineritë dhe pajisjet nuk janë në gjendje pune dhe shërbimi nuk ofrohet me këto mjete, kontraktuesi penalizohet.
- 13.4 Kontraktuesi është i detyruar që brenda datës së përcaktuar në kontratë për fillimin e kryerjes së shërbimeve të punësojë dhe të sigurojë në përputhje me legjislacionin shqiptar të gjithë punonjësit e tij, sipas përcaktimeve në "Specifikimet Teknike".
- 13.5 Përfaqësuesit e Kontraktuesit, të cilët marrin pjesë gjatë kontrollit të përditshëm të performancës së Shërbimeve, duhet të jenë të autorizuar zyrtarisht nga Drejtuesi Teknik i Shërbimit të Pastrimit ose nga Administratori i Kontraktuesit.
- 13.6 Nëse Kontraktuesi duhet të ndërpresë zbatimin e shërbimit të pastrimit, për një afat kohor të caktuar ose në një zonë të caktuar, për shkaqe teknike (punime për rikonstrukcionin e rrugëve) ndërprerja e Shërbimit ose rregullimet e mundshme duhet të njoftohen zyrtarisht dhe të kenë miratimin e Autoritetit Kontraktor, Bashkinë Shkodër, që konsideron të pranueshme këtë ndërprerje apo ndryshim.
- 13.7 Drejtori Teknik i Shërbimit të Pastrimit, është personi përgjegjës i cili autorizohet të nënshkruajë të gjitha procesverbalet dhe situacionet ditore, javore, mujore, baza për t'u përdorur për përgatitjen e certifikatës së pagesës (situacioneve), dhe që janë të mbajtura nga përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër.
- 13.8 Kontraktuesi është i detyruar të disponojë në çdo kohë e në gatishmëri të plotë, gjatë gjithë kohëzgjatjes së Kontratës, të gjitha mjetet dhe pajisjet e kërkuara për realizimin e Shërbimeve janë në përputhje me specifikimet teknike dhe ofertën e paraqitur në tender.
- Në rast se përdorimi i një pjese të paisjeve, është i pamundur për shkaqe teknike për zona



ose pika grumbullimi, Kontraktuesi mund të ndryshojë një pjesë të pajisjeve vetëm pas miratimit nga Bashkia Shkodër.

13.9 Kontraktuesi është i detyruar të realizojë shërbimin e marrë persipër në perputhje të plote me dokumentat e tenderit, metodologjise së punes si edhe specifikimeve teknike dhe grafikun e shërbimit pjese perberese e kesaj kontrate.

Neni 14 Raportimi

14.1 Kontraktuesi është i detyruar të raportojë përmes dorëzimit të raportit vjetor, listën dhe gjendjen aktuale të automjeteve (me targat perkatese) dhe pajisjeve të cilat përdoren për proceset e shërbimeve. Raporti duhet të përmbajë emrat ashtu edhe emërtesat e personelit mbikqyrës, të vendosur nga Kontraktuesi. Raporti duhet të dorëzohet përmes zyrës së protokollit në format tabelar dhe dokumente të printuara dhe të firmosura, si dhe në format elektronik në adresën zyrtare elektronike të Autoritetit Kontraktor sherbimetpublike@bashkiashkoder.gov.al

14.2 Kontraktuesi duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor, Bashkisë Shkodër, 5 (pesë) kopje të raportit vjetor, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga përfundimi i çdo viti kalendarik, të shoqëruar me situacionin e fundit vjetor të shërbimit, procesverbalet dhe statusit financiar.


14.3 Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkodër dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë rakordimin për situacionin e muajit paraardhës (procesverbalet e performancës së shërbimit, mos performancës së shërbimit dhe nën performancës). Kontraktuesi pas rakordimit brenda 5 (pesë) ditëve dorëzon Autoritetit kontraktor situacionin dhe faturën tatimore elektronike për situacionin mujor të rakorduar sipas volumit të shërbimeve të kryera për muajin paraardhës dhe dokumentacionin përkatës. Situacionet duhet të firmosen nga të dyja Palët në 5 (pese) kopje, dy prej të cilave i jepen Kontraktuesit.

14.4 Fatura duhet të jete elektronike dhe nuk bëhet në asnjë rast përpara rakordimit dhe nënshkrimit të situacionit. Kërkesa për pagesë duhet të shoqërohet me faturën tatimore dhe situacionin e rakorduar për performancën e Shërbimit për muajin paraardhës. Të gjitha dokumentet duhet të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor Bashkisë Shkodër përmes postës, ose përmes dorëzimit pranë sekretarisë/zyrës së protokollit së Autoritetit Kontraktor ndersa fatura tatimore ne format elektronik.

14.5 Bashkia Shkodër duhet të kryejë pagesat për Shërbimet brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga dita e dorëzimit të faturës. Mosdorëzimi/mosrakordimi i dokumentave i jep të drejtë Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër, të mos e paguajë Kontraktuesin deri sa ky i fundit të paraqesë faturën me bashkëlidhjet e kërkuara.

Neni 15 Specifikime dhe Skicime

15.1 Nëse Kontrata për qëllime të përmbushjes së objektit të saj kërkon shërbime skicimi, kontraktuesi duhet të përgatisë të gjitha specifikimet dhe skicimet e kërkuara duke përdorur sisteme të përparuara e të pranuar, të njohura në përgjithësi e të pranueshme





për Autoritetin Kontraktues Bashkinë Shkodër dhe duhet, kur është e mundur, të perdore standardet më të fundit.

15.2 Nëse Kontrata për qëllime të përmbushjes së objektit të saj kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të sigurojë se të gjitha specifikimet, skicimet dhe kërkesat e tjera janë përgatitur në bazë asnjëse përse i përket hapjes së konkurrencës në procesin e prokurimit.

Të përgjithshme

Bashkia ka si qëllim ofrimin e shërbimit të Pastrimit në të gjithë territorin e saj aktual me standarte dhe performancë të lartë, duke siguruar reduktimin e impakteve negative të mbetjeve në shëndetin e njerëzve dhe të mjedisit.

1. Të përgjithshme, zona Perëndimore.

Bashkia Shkodër ka në prioritetet të punës të përditshme dhe detyrave funksionale në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe akteve nënligjore përkatëse, ofrimin e shërbimit të pastrimit, me standarte dhe performancë sa më të lartë, duke siguruar reduktimin e impakteve negative të mbetjeve në shëndetin e njerëzve dhe të mjedisit.

Zona Perëndimore ka të përfshirë njësitë administrative Ana e Malit, Bërdicë, Dajç dhe Velipojë, dhe zonën e Plazhit Velipojë.

- Operatori sipërmarrës duhet të kryejë grumbullimin dhe transportin e mbeturinave të prodhuara në zonen Perëndimore dhe të realizojë depozitimin e tyre në landfillin e Bushatit;
- Është parashikuar që në zonen Perëndimore çdo ditë prodhohen për Njësitë administrative Ana e Malit, Bërdicë, Dajç dhe Velipojë mesatarisht 8.5 ton mbetje/dite, ndërsa për zonën e plazhit Velipojë për 110 ditët e sezonit turistik, mesatarisht 16.9 ton mbetje në ditë;
- Gjithashtu kompania duhet të kryejë edhe zera të tjera shërbimi të detajuara si me poshte sipas dhe preventivit të shërbimit.



HARTA E BASHKISE SHKODER Njesite Administrative



Zona Lindore

- NJA Guri i Zi
- NJA Rrethinat
- NJA Postrinë
- NJA Shalë
- NJA Pult

Zona Qendrore

- NJA Shkodër

POSTE Zona Perëndimore

- NJA Ana Malit
- NJA Bërdicë
- NJA Dajç
- NJA Velipojë




1.2 Kuadri Ligjor ku është bazuar përlogaritja e kostos të shërbimit të pastrimit.
Llogaria e kostos për shërbimin e Pastrimit është realizuar sipas modelit “ Per miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve “ miratuar me VKM nr.319 date 31.05.2018. Ketu përfshihen të gjitha elementet e këtij shërbimi sipas specifikimeve të mëposhtme. Proces pune më vete, jashtë kësaj metodologjie, është mirëmbajtja e zonës të plazhit/rërës para dhe mbas sezonit turistik, dezinfektimi i PGM , fshirja manuale , mirëmbajtja e plazhit me punëtorë, mirëmbajtja e PGM’ve, mirëmbajtje të tualeteve publike (cmimet e këtyre të fundit janë llogaritur me analiza An1-An6).

Përlogaritja e kostos me anë të modelit dhe metodologjisë, bazuar në VKM dhe analizat janë elementët bazë të përcaktimit të fondit limit për këtë shërbim dhe hartimin e preventivit të shërbimit. Të gjitha të dhënat në këtë dokument janë pa tvsh, Sipas legjislacionit, vlerën e TVSH e paraqesim në fund vlerës së preventivit .

2. Grumbullimi dhe Transportimi i Mbetjeve .

Nga eksperiencia e mëparshme, është vënë re që edhe me punën e sforcuar të operatorëve të shërbimit ka pasur probleme në përcaktimin dhe menaxhimin eficient të pikave të grumbullimit të mbetjeve kryesisht në zonën e qendër velipojë-plazh, pasi kjo është një zonë me fluks të lartë të frekuentimit nga turistë të huaj dhe vendas, me një numër të konsiderueshëm biznesesh dhe njësi akomoduese. Gjatë sezonit turistik, dhe kryesisht në muajin Gusht, PGM-të në këtë zonë ishin në çdo moment të tejmbushura pasi gjenerimi i mbetjeve është shumë i lartë për një territor aq të vogël. Për këtë arsye, në zonën e plazhit Velipojë, shërbimi i pastrimit tashmë do të realizohet duke zbatuar dy skenarë. Në zonën e qendër-Velipojë plazh do të realizohet shërbimi derë me derë (mjete do ndalet në stop-e të parashikuara nga autoriteti kontraktor) në territorin e përcaktuar nga grupi i punës i Bashkisë Shkodër, ndërsa për pjesën tjetër të këtij territori do vazhdohet shërbimi me kontenierë 1100 litra. Në zonën e katër njësisive administrative me territor rural, do vazhdohet gjithashtu shërbimi me kontenierë 1100 litra.

Pra, zona Perëndimore do ketë shërbim të ndarë në tre nën-zona:

 Zona 1– Përfshin të gjithë territorin e Njësive administrative përfshirë këtu nj.a Ana e Malit, Bërdicë, Dajç dhe Velipojë, ku shërbimi ofrohet gjatë gjithë vitit, 2 herë në javë për cdo njësi administrative, me kontenerë 1.1m³ dhe me dy mjete teknologjike 10 ton.

- Zona 2 , zona turistike e plazhit Velipojë (pa zonën 3) - shërbimi ofrohet gjatë 110 ditëve të sezonit veror, 1 herë në ditë/ 7 ditë në javë me kontenerë 1.1m³ dhe me 1 mjet teknologjik 10 ton.

- Zona 3, zona e Kompleksit Fishta, Rruga 8, 9, dhe qendra e plazhit të Velipojës – shërbimi ofrohet gjatë 110 ditëve të sezonit veror, 2 herë në ditë/ 7 ditë në javë, sipas modelit derë më derë me një mjet teknologjik 5 ton. Bizneseve muajin e parë operatori do ti furnizojë me qese për t’ua shpërndarë njësive të biznesit dhe atyre akomoduese. Më pas do të duhet ti sigurojnë vetë qeset bazuar në direktivat e Bashkisë zbatuar në muajin e parë të ndërgjegjësimit dhe rregullores përkatëse. Në përlllogaritjen e kostos është llogaritur edhe një kosto e caktuar për operatorin sipërmarrës për ta përdorur për fushatën e ndërgjegjësimit që do të duhet të realizohet sipas planit të punës të hartuar nga Autoriteti Kontraktor. Monitorimi i realizimit të fushatës ndërgjegjësuere dhe planit të punës nga ana operatorit, do të realizohet nga specialistët e monitoruesit e njësive të monitorimit të shërbimeve publike pranë Drejtorisë të Shërbimeve Publike.

Shërbimi i pastrimit sezonal është zgjeruar në kohë, dhe do kryhet nga data 01 qershor deri me datën 18 shtator me 110 ditë shërbimi. Sic u përmend më lart, për plazhin e Velipojës është përlllogaritur të ketë dy zona shërbimi: një zonë shërbimi me mbledhje derë më derë/stop-e (me qese) sipas itinerarit të përcaktuar më poshtë duke përfshirë bizneset, njësitë akomoduese, dhe njësitë e shërbimit për rrugët qendrore 8, 9, dhe kompleksin Fishta. Kompleksi Fishta përfshin të gjitha njësitë e shërbimit në këtë territor, rrugët 8 dhe 9 po ashtu përfshijnë të gjitha ato njësitë akomoduese dhe bizneset që kanë akses në rrugë. Kjo vendimmarrje është marrë si pasojë e problematikës të hasur gjatë sezonit turistik me zonën qendrore të plazhit të Velipojës , ku të gjitha bizneset, njësitë akomoduese të qendrës dhe kompleksi Fishta dorëzonin mbetjet në PGM, në cdo orar të ditës, në pikën kryesore të qendrës pranë lulishtes të Velipojës duke e kthyer atë në një hotspot mbetjesh.

Kjo vendimmarrje vjen nga testimi paraprak i realizimit të dy skenareve të grumbullimit të mbetjeve në sezonin turistik të vitit 2022. Gjatë sezonit turistik të vitit 2022 u testua skema e mbledhjes derë më derë dhe ndërgjegjësimi qytetar dhe të bizneseve për mbledhjen me orar të mbetjeve. Gjatë anketimeve në terren, bizneset dhe qytetarët ishin entuziast për këtë proces duke pasur parasysh reduktimin e ndotjes në qendrën e plazhit dhe uljen e volumit të pikave të grumbullimit në qendër. Me realizimin e këtij procesi risi për Bashkinë Shkodër, reduktohet numri i kontenerëve në plazhin e Velipojës dhe zvogelohet volumi i mbetjeve të pikave në qendër duke i dhënë zgjidhje ndotjes të gjithë zonës dhe , dhe të realizohet në zonën e qendrës mbledhja “derë më derë”.

Në territorin e mbetur do të vazhdojë të realizohet grumbullimi i mbetjeve me anë të kontenerëve sipas një orari të përcaktuar nga Bashkia duke marrë parasysh edhe kërkesat e banorëve, frekuentuesve të plazhit të Velipojës, njësive tregëtare dhe akomoduese.

Gjithashtu kompania duhet të kryejë edhe zera të tjera shërbimi të detajuara si më poshtë sipas preventivit, në shërbim të pastrimit sa më cilësor dhe eficient.



2.1 Volumet e punimeve.

Në zonën Perëndimore bëjnë pjesë NJA Velipoje, Dajç, Berdica, Ana Malit. Kjo zonë ka një popullsi prej 21167 banorë (sipas të dhënave nga formula e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë) pa zonën e plazhit në Velipojë, e cila gjatë stinës së verës, ka mesatarisht 21085 turistë/ditë. Zonat NJA Bërdicë, Ana Malit, Dajç dhe Velipojë kanë karakter rural ndërsa zona e plazhit në NJA Velipojë, ka karakter Semi-Urban, nga ku është përcaktuar edhe koeficienti i gjenerimit të mbetjeve për banor.

Në total në zonën rurale parashikohet të gjenerohen mesatarisht 8.5 ton/ditë mbetje të ngurta urbane, ose 3090 ton mbetje të ngurta urbane gjatë gjithë vitit, ndërsa për Plazhin, parashikohet një normë gjenerimi prej 16.9 ton /dita në 110 ditëshin e sezonit dhe 1856 ton në total gjatë gjithë sezonit. Mbetjet urbane duhet të grumbullohen dhe më pas transportohen në landfillin e Bushatit.

Parashikimi i volumeve ka marrë në konsideratë përveç koeficientit për banor bazuar në eksperiencën e deritanishme, edhe zbatimin e Planit Lokal të menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane 2017-2022 për Bashkinë Shkodër, me qëllim incentivimin e politikave të riciklimit dhe ndarjes të mbetjeve në burim duke shkuar kështu në zvoglimin e volumit të mbetjeve që dërgohen për trajtim në landfillin e Bushatit.


Kjo sasi mbetjesh do të mbledhet në terren nga 359 kontenierë metalikë/plastikë me kapacitet 1,100 litra (1.1m³) të shtrirë në njësitë administrative Dajç, Berdicë, Ana Malit dhe Velipojë, Zona 1. Ndërsa në zonën Velipojë- Plazh, zona 2 do të kemi të shërndarë 125 kontenierë, zona 3 është caktuar zonë pa kontenierë sepse do të aplikohet sistemi i mbledhjes derë më derë i mbetjeve urbane. Këto kontenierë janë pronë e Bashkisë Shkodër. Me kontratën e re, merren në dorëzim për administrim dhe mirëmbajtje nga operatori i ofrimit të shërbimit të pastrimit, nën vëmendje nga administrata e njësisë administrative monitorues të shërbimeve dhe administrator, bazuar në Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë për zbatimin e Procedurës standarte të veprimit (rregullore e brëndshme e administratës). Sipas planit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor për vendosjen e pikave të grumbullimit të mbetjeve, distanca midis tyre varion nga 100-500m larg, kjo për të ofruar një shërbim sa më cilësor, duke shkuar sa më afër banorëve. Në zonat e qendrave të NJA-ve dhe në zonën e plazhit, ku gjenerimi i mbetjeve është shumë i madh, në disa raste, pikat e grumbullimit të mbetjeve janë edhe në distancën 50-100m larg.

Grumbullimi i mbetjeve në njësitë administrative do bëhet sipas itinerarit të përshkruar më poshtë, që synon një proces sa më efikas dhe cilësor. Distanca totale e përshkruar nga mjetet vetëm për grumbullimin e mbetjeve në PGM në njësitë administrative përgjatë një frekuence është 187 km. Në zonën Velipojë-Plazh, distanca e përshkruar për grumbullimin e mbetjeve në PGM është 20 km, ndërsa për grumbullimin e mbetjeve derë më derë është 5 km.

2.2 Specifikime teknike dhe metodologjia.

-Shërbimi i grumbullimit (me kontenierë), largimit dhe transportit të mbetjeve të ngurta urbane konsiston në:

- a) Zbrazjen e konteniereve me makinën e përshtatshme teknologjike të përcaktuar;
- b) Mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të hedhura përreth në një distancë me rreze prej 5 m nga çdo kontenier;



- SHKODER
- c) Pastrim të sipërfaqes prej 30 m² rreth çdo pike grumbullimi;
 - d) Rivendosja e kontenierëve të sistemuar në vendin e caktuar. Kontenierët duhet të vendosen drejt, në pozicion vertikal dhe në mënyrë estetike për mjedisin urban dhe me kapakë të mbyllur;
 - e) Dezinfektimin e zonës së kazanëve (PGM), sipas normativave;
 - f) Transportin e mbeturinave në vendin e depozitimit të tyre, lëndfillin e Bushatit;
- Për mosrealizimin e kritereve përcaktuar në specifikimet teknike, përcaktohen penalitetet nga ana AK për punë të pa kryer nga operatori sipërmarrës.

-Shërbimi i grumbullimit (derë- më-derë), largimit dhe transportit të mbetjeve të ngurta urbane konsiston në:

- a) Mbledhjen e qeseve derë-më-derë me makinën e përshtatshme të përcaktuar, mjet teknologjik 5 ton.
 - b) Transportin e mbeturinave në vendin e depozitimit të tyre, lëndfillin e Bushatit.
- Për mosrealizimin e kritereve përcaktuar në specifikimet teknike, përcaktohen penalitetet nga ana AK për punë të pa kryer nga operatori sipërmarrës.


2.3 Frekuencat e grumbullimit

a) Në zonën Perëndimore shërbimi i grumbullimit të mbetjeve do të ofrohet sipas grafikëve të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor. Oraret e grumbullimit do të jenë ditën nga ora 06.00 deri në orën 12.00, për Nj.A.

b) Parashikohet që për Nj.A. të zonës Perëndimore të përdoren 2 mjete teknologjike 10 ton të cilat do të ofrojnë shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve 2 herë në javë për çdo njësi administrative, (bazuar në grafikun e rrugëtimeve si më poshtë me hartat përkatëse). Dy mjetet teknologjike 10 ton do të ofrojnë përkatësisht shërbimin në dy njësi administrative brenda ditës, rrugëtimi NJA Ana Malit dhe rrugëtimi NJA Bërdicë me dy mjete, (frekuenca e parë të hënën), vijojnë me dy njësitë e tjera të martën po me dy mjetet 10 ton NJA Velipojë dhe NJA Dajç, dhe kështu vazhdon gjatë javës të enjten me të dyja njësitë Ana e Malit dhe Bërdicë, dhe të premten Nj.a Velipojë & Dajç. Gjithsej behen 8 rrugetime ne total gjate javes. Koha që i duhet mjetit për të bërë vetem 1 cikël të grumbullimit të mbetjeve (nga PGM e pare qe evadon deri tek e fundit) është mesatarisht 3 ore. Ndersa koha qe i nevojitet mjetit per te kryer nje rrugetim (termi rrugetim i referohet rruges qe pershkon mjete nga pika e nisjes se kamionit ne park, gjate grumbullimit, dhe deri ne depozitim ne landfill) është mesatarisht 3.5 orë.

c) Për zonën e plazhit gjatë sezonit turistik të përcaktuar më 110 ditë kalendarike 01 qershor-18 shtator zona ndahet në zonën 2 dhe zonën 3 në shërbimin me kontenierë dhe shërbimin derë më derë. Në zonën 2 shërbimin me kontenierë frekuenca do jetë një herë në ditë, gjatë orarit të drekës apo mbasdites, 15:00-18:00. Për këtë periudhë do përdoret 1 mjet teknologjik 10 ton për shërbimin e grumbullimit të mbetjeve me kontenierë. Ndërsa, për zonën nr.3 Plazh Velipojë - shërbimi derë më derë, frekuenca do jetë dy herë në ditë, turni parë rreth orës 06.00-9.00 dhe turni dytë rreth orës 15.00-18.00.

Do të realizohet frekuenca dy herë në ditë në bazë të kërkesave të njësive tregëtare dhe për shkak të një sistemi të ri mbledhje që qytetaret do të duan kohë për tu ndërgjegjësuar vetëm me një orar grumbullimi. Do të lihen dy orare të ndryshme për të dorëzuar mbetjet tek






punëtorët e shërbimit që shoqërojnë mjetin teknologjik 5 ton. Pra do jene ne dispozicion 2 frekuenca, por qytetaret/bizneset do zgjedhin vete njerën frekuencë për të dorëzuar qeserit mbetje tek punetoret e shërbimit. Totali i volumit ditor të gjeneruar përkon me totalin e volumit të përlogaritur për tu mbledhur në dy oraret e caktuar për grumbullimin derë më derë (gjithsej 8.4 ton/dite). Oraret e turneve mund të ndryshohen me kërkesë dhe me miratim dypalësh, për t'ju përshtatur sa më mirë banorëve të cilëve do t'i ofrohet shërbimi. Koha që i duhet mjetit për të kryer një grumbullim plotësisht derë më derë është 2 orë. Është shumë e rëndësishme që meqenëse ky system i ri i grumbullimit vjen si risi për zonën e plazhit të Velipojës, edhe mbas një fushate ndërgjegjësimi, mjetit teknologjik që do të realizojë skemën e mbledhjes derë më derë i nevojitet një gramafon për njoftimin e ardhjes të mjetit për marrjen e mbetjeve në rrugët e caktuara nga Bashkia.

Iniciativa e grumbullimit të mbetjeve derë më derë, është një përpjekje që do shërbejë për ta shtrirë këtë mënyrë shërbimi në gjithë zonën e plazhit në të ardhmen. Kjo skemë shërbimi pasqyron një kualitet të lartë pasi eliminon PGM-të në zonën turistike, PGM të cilat jo rrallë herë kthehen në hotspote shkaktuar nga mbetjet e hedhura pa kriter ose edhe nga ndërhyrjet e njerëzve ose të kafshëve. Është llogaritur që njësitë të cilave do i ofrohet shërbimi do pajisen me qese plastike 120L, të parashikuara për çdo muaj të parë të nisjes të sezonit. Kjo do të shërbejë edhe si ndërgjegjësim për gjeneruesit e mbetjeve se si duhet të veprojnë me dorëzimin e mbetjeve në orar sipas një rregulli të caktuar. Në përlogaritjen e kostos është llogaritur një fond i vecantë për ndërgjegjësimin dhe stafin e operatorit që do të duhet të ndjekë me rigorozitet këtë proces. Një punonjës monitorues i zonës do të jetë përgjegjës për gjithçka ndodh në terren në këto 110 ditë sezoni turistik. Punonjësi do të duhet të japë kontaktet bashkisë Shkodër dhe administratës të njësisë administrative Velipojë në formën e një shkrese sipas përcaktive në kontratën dy palëshe. Monitorimi nga ana e Bashkisë do të realizohet me anë të administratës të njësisë administrative Velipojë përcaktuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë, me detyrat përcaktuar në PSV e administrimit të shërbimit të pastrimit.

Njësia e Monitorimit të shërbimeve publike pranë drejtorisë të shërbimeve publike është struktura që merr informacionin direkt nga monitoruesi i njësisë, nga specialist i operatorit dhe realizon të gjithë procedurën administrative në kuadër të zbatimit të Kontratës dhe PSV të administrimit të shërbimit. Kosto e ndërgjegjësimit ka të parashikuar edhe pajisje informuese dhe ndërgjegjësuese mbi sistemin e mbledhjes respektimin e orarëve etj. Fond i cili është përcaktuar në përlogaritjen e kostos për ndërgjegjësim do të përdoret vetëm për ndërgjegjësim dhe do të realizohet sipas një plani të hartuar nga Dr.e shërbimeve dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë Shkodër. Në rast moszbatimi parashikohen penalitete, dhe shuma i mbahet situacionit të muajit respektiv. Do të vazhdohet të kërkohet nga Bashkia Shkodër grumbullimi i rrymave të mbeturinave (të riciklueshme) për tu realizuar në bashkëpunim me bizneset e zonës me një marrëveshje të drejtë për drejtë tri palëshe.

Në tabelën më poshtë propozohet një kalendar i mundshëm në lidhje me ditët e ofrimit të shërbimit në secilën nga njësitë vendore:

Frekuenca	2 Mjete 10 ton	1 turn/ditë/mj et
------------------	----------------	-------------------------



SHKODER

	E Hënë	E Martë	E Mërkurë	E Enjte	E Premte	E Shtunë	E dielë
Zona perëndi	Ana Malit	Velipojë	pushim	Ana Malit	Velipojë	pushim	pushim
more Nj.A.	Bërdicë	Dajç		Bërdicë	Dajç		

Përbërja	Infrastruktura		Të dhënat teknike	
	Mjetet	Kontenierë	Norma e gjenerimit	Frekuenca
Njësitë e Zonës Perëndimore				
Ana Malit, Bërdicë, Velipojë, Dajç	2 mjete teknologjike 10 ton.	Shtohen 105 (Total 359)	0.4 kg/banorë/ditë	2 herë/javë
Velipojë Plazh Shërbim me kontenierë	1 mjet teknologjik 10ton	Shtohen 53 (Total 125)	0.8 kg/banorë/ditë	7ditë/javë
Velipojë Plazh Shërbim derë më derë	1 mjet teknologjik 5ton	Qese te njesive	0.8 kg/banorë/ditë	7ditë/javë

Grafiku i evadimit të mbetjeve mund të ndryshohet në bazë të nevojave, me miratimin e Autoritetit Kontraktues.

2.4 Plani i vendosjes së kontenierëve dhe grafikët e punimeve.

a. Autoriteti kontraktor ka përcaktuar pikat ekzakte të grumbullimit të mbetjeve të ngurta urbane, dhe numrit të kontenierëve për secilën pikë grumbullimi, në të gjithë zonën ku përfshihen edhe të gjitha pikat e grumbullimit .

b. Kontraktuesi është i detyruar të zbatojë planin fillestar të pikave. Ky plan mund të ndryshojë gjatë kohës së zbatimit të kontratës me propozim të kontraktuesit ose nga Autoriteti Kontraktor sipas nevojave për përmirësimin e shërbimit dhe mirë organizimit të tij, ose si rezultat i ndryshimeve që mund të ndodhin në infrastrukturë gjithmonë pas kërkesës së njëres palë dhe bëhen të zbatueshme pas miratimit të Autoritetit kontraktor.

c. Autoritetit kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur ndalesa, penalitete dhe gjopa për mosërbushjen e tyre.

2.5 Rregulla për tu zbatuar



a. Për asnjë rast nuk do të lejohen kazanë të tejmbushur me mbeturina, të patransportuara dhe mbeturina të lëna në zonen përreth kontenierëve. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm, kontraktuesi duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 1 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e kontraktuesit dhe do të vendosen penalitete.

b. Kontraktuesi ka për detyrë të kryejë grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane që depozitohen brenda zonës së kontraktuar edhe në rast se hidhen larg pikave të miratuara të grumbullimit të tyre. Në rastet kur mbetjet hidhen në mënyrë të përsëritur operatori i shërbimit ka të drejtë të kërkojë miratimin e vendosjes së kontenierëve dhe përfshirjen në grafikun e punimeve.

c. Kontraktuesi duhet të ketë një përfaqësues, i cili duhet të monitorojë punën në terren dhe të jetë në gatishtëri për të marrë vërejtjet e qytetarëve dhe Autoritetit kontraktor (fizikisht apo me komunikim telefonik) dhe për t'u dhënë zgjidhje problemeve të prezantuara brenda 1 ore nga marrja e njoftimit.

d. Kontraktuesi detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë, minimalisht numrin e kërkuar të makinerive, pajisjeve dhe punëtorëve.

e. Kontraktuesi detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve të transportit dhe shoferëve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të shërbimit.

f. N.q.s gjatë transportit derdhen papastërti nga makinat e shërbimit, brenda ose jashtë zonës së shërbimit, ato duhet të pastrohen menjëherë. Në të kundërt përveç shpenzimeve që duhet të përballojë kontraktori për mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të rëna gjatë transportit, ai do të përballlet me penalitetet e parashikuara në përputhje me këtë kontratë apo me gjoba të tjera në përputhje me ligjet dhe vendimet në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

g. Përdorimi i uniformave dhe masave të sigurimit teknik për punëtorët që kryejnë shërbimin e pastrimit është rigorozisht i detyrueshëm dhe në rast mozbatimi aplikohen gjoba për mosplotësim këtij detyrimi.


3. Mjetet dhe pajisjet.

Operatori i shërbimit duhet të vëre në dispozicion për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, (mbledhjes, transportit, largimit të mbeturinave) dhe të gjitha shërbimeve plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

Makina e nevojshme teknologjike për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave urbane si dhe shërbimeve mbështetëse, të kërkuara për realizimin e kontratës, janë të renditura si më poshtë:

a. Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 10-11 ton (por jo me shume se 11 ton, për arsye se mjeti do të kalojë edhe në terren të vështirë, ndaj madhësia dhe peshja e mjetit duhet të jenë sa më e ulët për kryerje në mënyrë efektive rrugetimin), raport kompaktimi 1:4 - 1:6, jo më i vjetër se viti 2008, **3 (tre) copë**:
Dy janë për NjA gjatë gjithë vitit, dhe një është për sezonin turistik në plazh Velipojë.

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, web www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.alfaqe 18 nga 58



SHKODER
Mjetet teknologjike duhet të plotësojnë normat e lejuara të shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull, të përcaktuara. Në zbatim të VKM 633 datë 26.10.2018 “Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorike dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje pozitive dhe ata me ndezje me kompresion që djegin gaz natyror apo të lëngshëm për përdorim në automjete”, i ndryshuar, sipas nenit 8 pika b dhe ç, duhet të jenë jo më të vjetër se viti 2008 dhe minimalisht të jenë Euro 3.

✓ Mjeti teknologjik pastrimi 10-11 ton për grumbullimin e mbetjeve në Njësitë administrative (Zonal), grumbullon mbeturinat me frekuencën dy herë në javë. Sasia e mbeturinave totale që grumbullohen për një frekuencë është 29.6 ton ose gjithsej 59.3 ton në javë. Jane kerkuar 2 mjete te cilet punojne me nga dy frekuenca në javë për të evaduar të gjithë sasinë e mbetjeve javore.


Sipas modelit “Per miratimin e masave per kostot e menaxhimit te integruar te mbetjeve” miratuar me VKM nr.319 date 31.05.2018, ne zone nevojiten 2 mjete me kapacitet 10-11 ton (85% faktor mbushje). Secili mjet grumbullon mesatarisht 7.4 ton per cdo rruge, prandaj për realizimin e plote te shërbimit duhet te realizohen 8 rrugë ne jave me dy mjete teknologjike (secili mjet ben nga 4 rruge te shperndara ne dite te ndryshme).

✓ Mjet teknologjik 10-11 ton për grumbullimin e mbetjeve të tërhequr nga kontenierët në zonën e plazhit gjatë sezonit turistik prej 110 ditësh, me frekuence nje here ne dite apo 7 here ne jave;

Sasia e mbetjeve totale që grumbullohet per nje frekuence eshte 8.5 ton. Sipas modelit “ Per miratimin e masave per kostot e menaxhimit te integruar te mbetjeve “ miratuar me VKM nr.319 date 31.05.2018, nevojitet 1 mjet me kapacitet 10-11 ton (85% faktor mbushje).

b.Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 5-6 ton’ raport kompaktimi 1:4 - 1:6, viti i prodhimit jo me I vjeter se viti 2008 , 1 (një) cope. Mjeti teknologjik 5-6 ton, është kerkuar per grumbullimin e mbeturinave ne zonën Plazh Velipojë me skenarin e mbledhjes derë më derë për 110 ditë të sezonit turistik. Ne kete zone gjenerohen rreth 8.4 ton mbetje ne dite, te cilat do te mblidhen me mjetin teknologjik (eshte perzgjedhur nje tonazh i ulet i mjetit pasi do kaloje ne rrugica te ngushta). Sipas modelit “ Per miratimin e masave per kostot e menaxhimit te integruar te mbetjeve “ miratuar me VKM nr.319 date 31.05.2018, nevojitet 1 mjet me kapacitet 5 ton (85% faktor mbushje) që do punoje me dy turne (rruge) per te realizuar plotesisht shërbimin (do grumbulloje mesatarisht 4.2 ton mbetje per secilen rruge.

Mjetet teknologjike 5-6 ton, duhet të plotësojnë normat e lejuara të shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull, të përcaktuara. Në zbatim të VKM 633 datë 26.10.2018 “Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorike dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje pozitive dhe ata me ndezje me kompresion që djegin gaz natyror





apo të lëngshëm për përdorim në automjete”, i ndryshuar sipas nenit 8 pika b dhe c, duhet të jenë jo më të vjetër se viti 2008 dhe minimalisht të jenë Euro 3.



Ne llogaritjen e kostove operative (per mjetet) merret ne konsiderate kostoja e mirembajtjes se tyre. (siguracion, taksa, vaj, filtra, goma, mirembajtje mekanike, parking); Kostoja e amortizimit per llogaritje per mjetet e perdorura eshte marre 15 % ne vit; c-Mjet teknologjik pastrimi reserve 5 -6ose 10-11 ton.Ky mjet nevojitet per zevendesim ne rast se eshte me defekt ndonje mjet.

Nr	Emertimi I mjetit	Kapaciteti	Sasi (copë)
1	Mjete teknologjike pastrimi (per Nj.a'të)	10-11 ton	2
2	Mjete teknologjike pastrimi (sezonal per plazhin)	10-11 ton	1
3	Mjete teknologjike pastrimi (sezonal per plazhin)	5-6 ton	1
4	Mjete teknologjike pastrimi reserve	5-6 ose 10-11 ton	1

Lloji i mjetit	Mjet teknologjik transportues (kompaktor)
Ngarkimi fundor i makinës (kapaciteti i mjetit)	10-11 ton/5-6ton 
Raporti i Kompaktimit	1:4 – 1:6
Kapja e mjetit në pjesën fundore	Duhet të jetë me krahë kapës për kontenierë me volum 1100 litra (1.1m ³) 



Plotat e mjetit	Duhet të jenë rrota të mëdha të cilat të mund të lëvizin lirisht në territore malore dhe të mbuluara me borë
Nëse mjete është i përdorur	Jo me i vjetër se viti 2008
Lënda djegëse	Diesel
Marshi	Manual

3.1 Rregulla të tjera për mjetet dhe pajisjet:


- a. Të gjitha mjetet të cilat do të përdoren nga operatori i shërbimit për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, mund të kontrollohen në çdo kohë nga Autoriteti kontraktor për gjëndjen e gatishmërisë dhe inventarizimin e tyre;
- b. Të gjitha mjetet të cilat do të përdoren, duhet të jenë të identifikuara nga Autoriteti kontraktor. Ato duhet të mbahen në gjëndje të pastër dhe të rregullt. Një pjesë e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të jenë gjëndje për të siguruar plotësimin e gatishmërisë së mjeteve;
- c. Mjetet e largimit të mbeturinave duhet të lahen dhe dezinfektohen çdo ditë pas përfundimit të punës;
- d. Detyrimisht në të gjithë makinat duhet të shkruhen mesazhe për edukimin mjedisor, numri i telefoni i gjelbër i Autoritetit kontraktor sipas një formati të miratuar paraprakisht po nga Autoriteti Kontraktor. Gjithashtu në të gjitha mjetet përveç mbishkrimeve të mësipërme, duhet të prezantohen shpjegues të qartë për llojin e mbeturinave që mblidhen, si dhe orarin kur largohen mbeturinat;
- e. Autoriteti Kontraktor në plan ka parashikuar një grafik të lëvizjes së mjeteve, por Kontraktuesi duhet të mundësojë një hartë të rrugës më eficiente që duhet të ndjek mjete për grumbullimin e mbetjeve në zonën përkatëse dhe kalendarin përkatës;
- f. Kontraktuesi do të realizojë instalimin e sistemit të GPS në të gjitha mjetet teknologjike e jo teknologjike. Autoritet kontraktor do lidhet me këtë system nga kontraktuesi. Kontraktuesi do mundësojë nëpërmjet serverit qendror të sistemit GPS realizimin e sistemit të monitorimit nga Autoriteti Kontraktor. Kjo do të mundësojë një monitorim të hollësishëm të lëvizjes të të gjitha mjeteve, që Autoriteti Kontraktor mund ta përdorë për qëllime të ndryshme (kontroll nga njësia e monitorimit). Autoriteti Kontraktor do të monitorojë të gjitha lëvizjet e mjeteve teknologjike në zonat përkatëse dhe do të ketë mundësi kontrolli më të mirë në lidhje me rrugën e mjeteve, ndalesave të tyre në pikat e grumbullimit të mbetjeve, minutazhin që mjetet harxhojnë për zbrazjen e kontenerëve dhe kohën që ato harxhojnë për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve. Sistemi i GPS nuk duhet të shkëputet nga lidhja me Autoritetin Kontraktor për asnjë moment, si dhe nuk duhet të shkëputet nga lidhja me mjetin. Nëqoftëse rezulton sistemi i fikur tek Autoriteti Kontraktor ,apo dhe tek mjetet, kontraktuesi do penalizohet.





3.2 Kushtet teknike për mjetet e transportit.

- a. Të gjitha mjetet e transportit duhet të jenë në gjendje të mirë teknike për të mundur grumbullimin e mbeturinave. Duhet të kenë një sistem ngarkimi të përshtatshëm me kontenierët që do të përdoren në NjA;
- b. Sistemi mekanik i ngarkimit duhet të jetë i gjithi funksional dhe të lejojë kryerjen e një cikli të plotë (ngritjen e kontenierit, shkarkimin dhe uljen e tij (130 kg) në një periudhë kohore të limituar prej 20 sekondash. Sistemi mekanik i ngritjes duhet të funksionojë vetë dhe nuk duhet që puntorët të ngrënë kontenierin për ta varur atë në këtë sistem.
- c. Makinat teknologjike duhet të jetë në një gjendje të mire, pa rrjedhje të ndonjë fluidi, dhe në gjendje të punojë 8 orë në ditë në mënyrë të vazhdueshme pa ndërprerje për arsye mekanike. Gjithashtu ato duhet të jetë i aftë për të lëvizur me një shpejtësi prej 80 km/h. Shkarkimet e gazërave të djegies nga makinat teknologjike duhet të jenë në përputhje me normat e legjislacionit në fuqi.
- d. Dritat e përparme dhe të pasmet duhet të jenë në gjendje të mire dhe makinat duhet të jetë gjithashtu të pajisur me reflektorë. Makinat teknologjike duhet të jenë të pajisur me pasqyra të jashtme për të pasur një vision të qartë mbrapa, me mbajtëse/suport për puntorët, me sistem komunikimi (radio ose telefona) të cilat duhet të jenë të lidhura me qendrën e operimit.
- e. Sistemi i ngjeshjes duhet të jetë në gjendje të mirë për të lejuar një shkallë të mirë ngjeshje për të realizuar ngarkimin e sasisë së kërkuar të mbeturinave brenda volumit të kamionit (respektivisht 10-11 dhe 5-6 ton)
- f. Në qoftë se një makinë është jashtë shërbimit, kontraktuesi duhet ta zëvendësojë atë me shpenzimet e tij me një makinë të ngjashme me të përgjatë gjithë kohës së riparimit të saj. Të tilla situata nuk duhet të kenë ndonjë influence apo ndikim mbi sasinë dhe cilesinë e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve.
- g. Makinat teknologjike duhet të lahen cdo ditë dhe të tregohet kujdes për to. Ato duhet të sigurojnë një grumbullim të sigurt, të pastër dhe higjienik të mbetjeve.
- h. Shoferi duhet të mbajë një libër ditor ku të tregojë të gjithë informacionin për punën e bërë cdo ditë: orën kur ka filluar grumbullimi, pushimet gjatë shërbimit, orët e shkarkimit, rrugët e bëra dhe numrin e kontenierëve të mbledhur.
- i. Kompania duhet të ketë gjithashtu një regjistër për cdo makinë teknologjike, ku të jepet i gjithë informacioni në lidhje me karburantin (datat, orët dhe sasinë), vajin dhe të tjera aktivitete të mirëmbajtjes.
- j. Në qoftë se makinat teknologjike nuk do të plotësojnë këto kërkesa, si pasojë e neglizhencës në mirëmbajtje nga kompania, atëherë njësitë administrative duhet të kërkojnë zëvendësimin e tyre.
- Me nënshkrimin e Kontratës, respektimi i kriterëve të specifikimeve teknike për mjetet teknologjike që vihen në dispozicion të shërbimit të pastrimit në zonën perëndimore realizohet nga grupi i punës ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë.





SHKODË

- 4. Skenaret e levizjes se mjeteve per grumbullimin e mbetjeve urbane.
- 4.1 Zona Perëndimore (Zona 1)


Zona Perëndimore (Fshati Gomsiqe - NJA Ana Malit - Landfilli Bushat)

1 mjet 10 ton – rruga e përshkuar nga parku deri në landfill për grumbullimin e mbetjeve (70 km)



4.2 Zona Perëndimore (Fshati Gomsiqe - NJA Bërdicë - Landfilli Bushat)



1 mjet 10 ton – rruga e përshkuar nga parku deri në landfill për grumbullimin e mbetjeve (40 km)



SHKODER

3 Zona Perëndimore (Fshati Gomsiqe - NJA Dajç - Landfilli Bushat)


1 mjet 10 ton – rruga e përshkuar nga parku deri në landfill për grumbullimin e mbetjeve (72 km)






4.4 Zona Perëndimore (Fshati Gomsiqe - NJA Velipojë - Landfilli Bushat)

1 mjet 10 ton – rruga e ërshkuar nga parku deri në landfill ër grumbullimin e mbetjeve (85 km)



SHKODER

4.3 Përmbledhje e rrugëtimit në Zonën Perëndimore - Njësi Administrative




Përmbledhje e rrugëtimit I, II, III, IV në Zonën Perëndimore - Njësi Administrative



4.6. Zona Perëndimore - Velipojë Plazh.

Zona Perëndimore (Fshati Gomsiqe - Velipojë Plazh (me konteniere)- Landfilli Bushat)



1 mjet 10 ton – rruga e përshkuar nga parku deri në landfill për grumbullimin e mbetjeve (54 km)



Zona Perëndimore - rrugëtimi V (Fshati Gomsiqe – Velipojë Plazh (me konteniere) – landfill Bushat)

Zona Perëndimore (Fshati Gomsiqe - Velipojë Plazh (derë-më-derë)- Landfilli Bushat)


2 mjete 5 ton – rruga e përshkuar nga parku deri në landfill ër grumbullimin e mbetjeve (39 km)




Zona Perëndimore - rrugëtimi VI (Fshati Gomsiqe – Velipojë Plazh (derë-më-derë) – landfill Bushat)


4.8 Tabela përmbledhëse për rrugëtimet në Zonën Perëndimore

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr. 1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al





ZONA PERËNDIMORE		E Hënë	E Martë	E	E Enjte	E Premte	E Shtunë	E Diele
Rrugëtimi I	Ana Malit							
<i>Nisja</i>	Fshati Gomsiqe Velipojë							
<i>Pika fundore</i>	Landfill Bushatit							
<i>Gjatësia e rrugës grumbullim + transport (1 kah vajtje)</i>	70 km							
<i>Kohëzgjatja</i>	3h 25'							
<i>Mjeti - I</i>	1 mjet 10ton							
Rrugëtimi II	Bërdicë							
<i>Nisja</i>	Fshati Gomsiqe Velipojë							
<i>Pika fundore</i>	Landfill Bushatit							
<i>Gjatësia e rrugës grumbullim + transport (1 kah vajtje)</i>	40km							
<i>Kohëzgjatja</i>	1h 50'							
<i>Mjeti-II</i>	1 mjet 10ton							
Rrugëtimi III	Dajç							
<i>Nisja</i>	Fshati Gomsiqe Velipojë							
<i>Pika fundore</i>	Landfill Bushatit							
<i>Gjatësia e rrugës grumbullim + transport (1 kah vajtje)</i>	72 km							
<i>Kohëzgjatja</i>	4h 10'							
<i>Mjeti - I</i>	1 mjet 10ton							
Rrugëtimi IV	Velipojë							
<i>Nisja</i>	Fshati Gomsiqe Velipojë							
<i>Pika fundore</i>	Landfill Bushatit							
<i>Gjatësia e rrugës grumbullim + transport (1 kah vajtje)</i>	85 km							
<i>Kohëzgjatja</i>	4h 45'							
<i>Mjeti-II</i>	1 mjet 10ton							



SHKODER


ZONA PERËNDIMORE		E Hënë	E Martë	E	E Enjte	E Premte	E Shtunë	E Diele
Rrugëtimi V	Velipojë Plazh Mbledhje me konteniere							
<i>Nisja</i>	Fshati Gomsiqe Velipojë							
<i>Pika fundore</i>	Landfill Bushatit							
<i>Gjatësia e rrugës grumbullim + transport (1 kah vajtje)</i>	54 km							
<i>Kohëzgjatja</i>	3h15'							
<i>Mjeti-III</i>	1 mjet 10ton							
Rrugëtimi VI	Velipojë Plazh Mbledhje dere-medere							
<i>Nisja</i>	Fshati Gomsiqe Velipojë							
<i>Pika fundore</i>	Landfill Bushatit							
<i>Gjatësia e rrugës grumbullim + transport (1 kah vajtje)</i>	39 km							
<i>Kohëzgjatja</i>	2h 20'							
<i>Mjeti-IV</i>	2 mjete 5ton							

5. Personeli.

a. Personeli i nevojshëm për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave është një shofer dhe dy puntorë për çdo makinë që grumbullon dhe transporton mbetjet. Meqenese per NJ. Administrative duhen 2 mjete, atehere personeli i nevojshem eshte 2 shofere dhe 4 punetore gjate gjithë vitit. Ne periudhen e sezonit turistik nevojiten gjithashtu 2 mjete, dhe personeli i shtuar sezonal do jete 2 shofere dhe 4 punetore.

b. Kushtet e punës për të gjithë stafin duhet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kështu stafi duhet të jetë i paisur me rrobat e përshtatshme të punës, me shenja dalluese që do të bëjnë të mundur identifikimin e tyre dhe gjatë natës, me doreza dhe paisje të tjera mbrojtëse për sigurimin teknik në punë. Gjithcka është e përlogaritur në koston e shërbimit

Kerkesa per puntori:



Nr	Specialiteti	Njesi	Sasi
A	Puntore efektiv per gjithe vitin (zona 1)	persona	13
1	Shofere	persona	2
2	Puntor per mjetin teknologjik	persona	4
3	Drejtues teknik i kontratës	persona	1
4	Specialist , monitorues terreni	Persona	1
5	Punëtorë të përfshirë në pastrimin e plazhit/rërës (para hapjes të sezonit turistik dhe mbas përfundimit të sezonit)	Persona	5
B	Puntorë sezonal (110 ditë të sezonit turistik)	Persona	30
1	Specialist , monitorues terreni	Persona	1
2	Shofere	Persona	2
3	Puntor makine per grumbullim mbeturina sezonal	persona	4
4	Puntore per fshirje	persona	2
5	Puntore per mirembajtje ne zonen e reres (plazh Velipojë & Baks Rrjoll).	persona	4+1 rezerve
6	Punëtorë për mirmbajtjen e PGM've	persona	5+1 rezerve
7	Punetore per mirmbajtjen e kater tualeteve publike	persona	8+2 rezerve

5.1. Puntore efektiv per gjithe vitin (zona 1)

1. Kostot e puntorisë për zërin e preventivit “grumbullimi dhe transporti i mbetjeve urbane” është përllogaritur sipas modelit të përllogaritjes të kostos në zbatim të VKM nr.319 date 31.05.2018. Sipas kësaj përllogaritje është shfaqur nëvoja për këtë nr.punëtorie bazuar në tonazhin e mbetjeve për nja'të, mjeteve në dispozicion për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve.

2. Zëri punëtorë të përfshirë në pastrimin e plazhit/rërës (para hapjes të sezonit turistik dhe mbas përfundimit të sezonit) i bazohet Analizës An-2. Eksperienca e mëparshme me parapërgatitjet për hapjen e sezonit turistik në plazh Velipojë dhe mbylljen gjatë muajit shtator, ka shfaqur problematika në ndotjen e këtij territori nga prurjet e detit me shirat e dimrit & pranverës para sezonit, me nisjen apo mbylljen e punës të njërive tregëtare, me pastrimin e stacioneve të plazhit, njërive akomoduese etj. Për këtë u vendos që të shtohen punëtorë në 21 ditë pune në total para/pas sezonit turistik, për ta mbajtur territorin e pastër në zonën e plazhit të Velipojës. Grafiku do të dorëzohet në formë shkresore nga ana e AK për operatorin sipërmarrës të shërbimit dhe do monitorohet në vazhdim sipas procedurës standarte dhe kontratës. Analiza An-1 paraqet përllogaritjen e kostos të këtij shërbimi. Këtu numëri I punëtorisë është llogaritur për 21 ditë dhe për 168 orë e pune të shpërndarë në të gjithë brezine rërës të plazhit të velipojës. Duhet 5 punëtorë për plazhin e velipojs 7 km së bashku me baks rrjoll. Punëtorët do të jenë të angazhuar vetëm ditët javore të punës dhe vetëm në tetë orarin e punës. Ditët e punës në ëekend do të zëvendësohen me ditët e javës sipas një grafiku përcaktuar nga Dr.e shërbimeve dhe miratuar nga AK. Punëtorët do të përfshihen edhe në mbledhjen e papastërtive që rëndomtë hidhen nga mjetet e turistëve nëpër rrugën nacionale të Velipojës.

Punëtorë sezonalë në 110 ditët të sezonit turistik.

1. Për fshirje manuale janë kërkuar dy punëtorë, kosto e llogaritur sipas Analizës sipas An-3;


2. **Mirëmbajtjes së PGM-ve, pastrimin perqark saj.**

Puntorë per mirembajtje të PGM-ve janë kërkuar gjashte punëtorë, nga keto pese duhet te jene te perhershëm nje rezerve per te zevendesim kur eshte e nevojshme. Numëri i pikave të grumbullimit në velipojë me sistemin e ri të mbledhjes të mbeturinave është ulur me 80 PGM. Numëri në total I PGM është 80 dhe në një distancë në total 20 km. Problematika e hasur gjatë gjithë sezonit turistik dhe jo vetëm edhe për gjatë gjithë vitit është mungesa e pastërtisë në pikat e grumbullimit për shumë faktorë.

Mos respektimi i orareve të dorëzimit të mbetjeve, dorëzimi me karroca i mbetjeve në pikat e grumbullimit duke i hedhur përqark pikave të grumbullimit, kafshët e ndryshme si kuaj lopë dhe qen që kanë akses me pikat e grumbullimit etj, bëjnë që pikat të jenë problematike me mbetje përreth edhe kur kontenierët janë evaduar. Është menduar që me caktimin e orarit nga ana e AK për qytetarët dhe banorët e përherëshëm të këtij territori cdo 16 pika grumbullimi të kenë një mirëmbajtës ku do të përgjigjet në cdo kohë sipas orarit të përcaktuar mbi mirëmbajtjen e pikës në të gjitha elementët e saj. Pika duhe të jetë e pastër në cdo kohë dhe në raste kur rezulton e pa pastër për cdo arsye do të ndërmerren penalitete. Bashkia Shkodër përgatit një grafik pune për mirmbajtësit duke i caktuar pikat cdo mirëmbajtësi, mundësisht pranë nj-tj dhe oraret e punës sipas Analizës An4. Fondi I pagave eshte perllogaritur per pese punetore dhe nje puntor rezerv i cili do te duhet te angazhohet ne raste nevojte te AK nga operatori sipermarres, ne total 6 punetore. Në analizën e koston janë perllogaritur ditët e festive dhe fundjavës, në zbatim të kuadrit ligjor përkatës cdo punëtori i është llogaritur paga me 126 ditë pune. Stafii i mësipërm do të punësohet nga Kontraktori. Kushtet e punës për të gjithë stafin duhet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kështu stafii duhet të jetë i paisur me rrobat e përshtatshme të punës, me shenja dalluese që do të bëjnë të mundur identifikimin e tyre dhe gjatë natës, me doreza dhe paisje të tjera mbrojtëse. Listat e punonjesve duhet ti paraqiten Autoritetit Kontraktual me kërkesën e AK.

3. **Puntore per mirembajtje ne zonen e reres (plazh Velipojë & Baks Rrjoll).**

Gjithashtu për sa i përket zonës të rërës janë caktuar kater punëtorë ne total per gjithe zonen e reres dhe nje rezerve per nevoja te Ak, per tu angazhuar nga operatori sipermarres . Nga keto për baks-rrjollin dy punetore duhet te jene stacionar në Baks-Rrjoll dhe dy punëtorë për te gjithe territorin e reres ne plazhin e velipojes. Meqënëse pastrimi i parcelave të plazheve private do të jetë një përgjegjësi e subjektit privat që e menaxhon plazhet private, pastrimi dhe mirëmbajtja e rërës (për hapësirat publike) në plazhin e Velipojës dhe të Baks – Rjollit do të kryhet me puntorë sezonal. Këta puntorë do të realizojnë grumbullimin e mbeturinave, që mund të jenë të përhapura nëpër rërë, me qese plastike. Meqenëse raporti i plazheve publike dhe private është përcaktuar 80% plazhe private dhe 20% plazhe publike atëherë vetëm 4(kater) punëtorë mundet të realizojnë pastrimin e plazheve publike dhe nje puntor do te duhet te jete rezerv kur te jete e nevojshme te angazhohet nga kontraktuesi, ne total



pese punetore per pastrimin e zones te reres gjate sezonit veror. Grafiku i punës do të realizohet nga ana e autoritetit kontraktor dhe operatori do të jetë i detyruar të dorëzojë në fund të sezonit turistik listën e punëtorëve të punësuar dhe që i është realizuar pagesa e sigurimeve shoqërore. Analiza për këtë zë është llogaritur sipas An- 5.Kostot administrative kanë të përcaktuar shpenzimin administrative të kontratës , kosto e cila është përllogaritur në analizën e përgjithshme të koston.

6. Dezifektimi i PGM

6.1 Volumet e punimeve

a. Duhet të bëhet dezifektimi i zonës përreth kontenierëve, pas zbrazjes së çdo kontenieri, me pluhur gëlqereje me 5% përmbajtje klori, duke përdorur sistemin e dezifektimit që duhet ta ketë çdo makinë teknologjike, duke përdorur të tretur lëndën e pluhurit të gëlqeres me 5% përmbajtje klori.

b.Frekuenca e dezinfektimit është një herë në javë për periudhën 110 ditë (cdo ditë premtë në zonën e plazhit), ndërsa njësitë administrative një herë në dy javë për sezonin e verës dhe një herë në muaj për periudhën tjetër të vitit.

Përllogaritja e koston për Kg të dezifektantit paraqitet në An-1.

7. Menaxhim dhe mirembajtje kontanierësh.

7.1 Menaxhimi i kontenierëve:


a. Operatori sipërmarrës merr në dorëzim kontenierët me proces-verbal midis palëve, në zbatim të procedurës standarte/rregullores. Vendosja e kontenierëve do të përcaktohet nga Autoriteti Kontraktor. Gjatë zbatimit të kontratës, kontraktuesi mund të zhvendosin kontenierë (duke ruajtur numrin rendor të tyre) në sajë të një kërkesë fillestare të bërë dhe të miratuar nga Autoriteti Kontraktor. Të gjitha lëvizjet e kontenierëve janë të përfshirë në çmimin e kontratës.

b.Kontenierët do të identifikohen me një numër rendor për tu zëvendësuar me një barkod, që do të mundësojë identifikimin digital të tyre nga grupi i monitorimit në Bashki. Kjo e fundit kur Bashkia të ketë të zbatueshme sistemin e barkodit. Deri atëherë kontenierët do të kenë numërin e tyre rendor për identifikim. Kontraktuesi dhe AK duhet të mbajnë një databazë me të gjithë kontenierët.

c.Sipërmarresi i shërbimit është i detyruar të zëvendësojë në total për tre vite 105 kontenierë në zonën nr.1 për cdo vit nga 35 kontenierë, dhe në zonën 2 në total të zëvendësojë 53 kontenierë për cdo vit 18 kontenierë. Kontenierët do të jenë metalike të xinguar 1100 litrash dhe do blihen në fund të cdo gjashtëmujori/viti sipas urdhërit nga AK. Furnizimi dhe me pas ndarja do behet në marreveshje me Autoritetin Kontraktor. Për mosrealizim të blerjeve të kontenierëve sipas planit miratuar nga AK, sipërmarresit në fund të çdo gjashtëmujori/viti, në situacione do të ndalet vlera e kontenierëve të pa blerë.

7.2 Mirëmbajtja e kontenierëve:

a. Inspektorët e monitorimit të shërbimit të pastrimit me detyrën e monitorimit të përditshëm të shërbimit të pastrimit, identifikojnë kontenierët që kanë nevojë për mirëmbajtje riparime



nga dëmtime të ndryshme të kontenierit. Autoriteti Kontraktor i kërkon kontraktuesit të marrë masa sipas një grafiku të përcaktuar sipas nevojave dhe një grafiku respektiv. Operatori duhet të riparojë kontenierët brenda një afati të përcaktuar nga AK, me të gjitha shërbimet në rast të nevojës për zëvendësim të kontenierëve, atëherë kur është e nevojshme. Përsa kohë konteneirët janë projektuar për një përdorim intensiv, ata nuk duhet të kenë nevojë për riparime nëse ato trajtohen ashtu siç duhet gjatë procesit të grumbullimit të mbetjeve. Pas grumbullimit kontenierët duhet të vendosen në pozicionin e tyre të mëparshëm.

7.3 Grafikët e punimeve

1. Grafikët e punimeve për riparimet e kontenierëve, përgatiten nga Kontraktuesi/monitoruesit dhe miratohen nga Autoriteti kontraktor.
2. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga Kontraktuesi.
3. Zbatimi i detyrës të përcaktuar nga AK, monitorohet dhe raportohet nga inspektorët e njësive administrative caktuar si monitorues të shërbimit të pastrimit me urdhër nga AK.
3. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar dhe për të vendosur penalitete, gjoha dhe ndalesa për mospërmbushjen e tyre.

8. Fshirja e manuale e rrugëve

8.1 Volumet e Punimeve dhe mjetet e punës.

Autoriteti kontraktor ka parashikuar për fshirjen manuale të rrugëve kryesore në qendër të plazhit përcaktuar në hartën si më poshte. Kjo përfshin Rrugën 9, rrugën përbri komplekstetit fishta dhe rrugën përreth lulishtes kryesore.

Operatori i shërbimit do të fshijë me krahë dhe do të kryejë të gjitha shërbimet e tjera mbështetëse parashikuar në metodologji për të gjithë sipërfaqen e parashikuar në zonën që do të kontraktohet, në një sipërfaqe të përgjithshme prej 5200 m²/ditë. Këto janë parashikuar në grafikonin e listës së rrugëve dhe volumet e tyre për shërbimin e fshirjes. Meqenëse norma për punëtor është 8000 m² këtu përcaktohet një punëtor për zonën qendër Velipojë dhe një punëtor për fshirjen dhe mirëmbajtjen pastër të pedonale të plazhit.

Shërbimi i fshirjes së rrugëve do të aplikohet vetëm në Velipojë, në zonën e plazhit në rrugët e paraqitura në skicën e mëposhtme (përfshihen rrugën hyrëse drejt qendrës nga të dyja korsitë me nga 1.5 metër nga kuletat, rrugët e përbri lulishtes kryesore të qendrës si dhe rruga përgjatë ndërtimeve tek Fishta.

Fshirja manuale e këtyre rrugëve nënkupton, largimin e mbeturinave, gjethëve si dhe të baltës dhe pluhurave. Të gjitha materialet e mbledhura duhet të depozitohen në pikat e grumbullimit të përkohshëm të mbeturinave dhe jo të depozitohen në ndonjë vend tjetër. Kompania duhet të sigurojë që kjo rrymë mbetjesh nuk përfundon në kuletat dhe kanalet e ujrave të shiut. Punëtorëve i është parashikuar në përlllogaritjen e kostos pajisja me mjete pune. Zbatimi, do të monitorohet nga AK në çdo kohë.

Fshirja e rrugëve do të bëhet një herë në ditë në mëngjes nga ora 05.00-07.00. Parashikohet që në total të fshihen rreth 572.000 m² sipërfaqe rruge për 110 ditë të sezonit turistik.



Frekuenca e fshirjes do të jetë një herë në ditë herët në mëngjes dhe do të kryhet nga dy punëtorë sezonal me fshesë cdo ditë të javës nga e hëna deri të djelën. Punëtori duhet të jetë i pajisur me karrocë dore, fshesë si dhe një lopatë për marrjen e mbeturinave. Punëtori duhet të kenë veshjet e përshtatshme të punës dhe me shenjat dalluese të kompanisë. Çdo punëtor duhet të jetë i pajisur me mjete pune pastrimi si fshesa plastike, kaci, karroca dore, lopata, etj për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit. Pajisjet dhe veglat e punës të mbahen në gjendje të pastër dhe të mirë. Punëtorët e fshirjes duhet të jenë të pajisur me uniforme.

Figura 3 Rrugët që do të fshihen në NJA Velipojë



8.2 Plani i punës , grafikët e punimeve dhe rregulla për tu zbatuar

- a. Fshirja e rrugëve do të bëhet një herë në ditë në mëngjes nga ora 05.00-07.00.
- b. Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zones, përgatiten nga Autoriteti kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në destinacione apo dhe në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes apo në rastet e ndryshimit të parkimit të makinave për rrugë të veçanta dhe ditë të veçanta dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktor këto ndryshime.
- c. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit.
- d. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë si dhe për të vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa për mospërbushjen e tyre.
- e. Për asnjë rast nuk do të lejohen rrugë të papastruara apo mbeturina të pa larguara në to. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm të cilat nuk mund të pastrohen me operacionet e parashikuara në metodologji, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 1 orë nga orari i

përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e Kontraktorit.

f. Kontraktori detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve dhe pajisjeve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të shërbimit.

g. Gjatë procesit të fshirjes i ndalohet kategorikisht hedhja e mbeturinave në pusetat e elektrikut, telefonisë, të ujësjellësit, ujrave të zeza, hidrantëve, në zgarat e pusetave të ujrave atmosferike, në shtretërit e ujrave rrjedhëse, zonat e gjelbra, në banesat ujore natyrale apo artificiale, etj. Në rast të konstatimit të kësaj dukurie Kontraktori detyrohet t'i pastrojë menjëherë. Në rast të përsëritjes, përveç përgjegjësisë së mbartjes së shpenzimeve përballet me penalitete sipas kësaj kontrate dhe ligjeve e vendimeve në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

h. Përdorimi i uniformave për punëtorët është rigorozisht i detyrueshëm dhe do ndërmerren gjopa për mosplotësim të tyre.

9. Mirmbajtja e WC Publike

Plazhi i Velipojës ka katër WC publike që kërkojnë të mirmbahen gjatë sezonit turistik prej 110 ditësh. Për këtë janë planifikuar 8 punëtorë për të katër tualetet publike nga një punëtor në turn për shtatë ditët e javës dhe dy punëtorë reserve të cilët do të duhen të angazhohen në rast nevojë të AK nga operatori sipërmarres. Në analizën e kostos janë përlllogaritur ditët e festive dhe fundjavës, në zbatim të kuadrit ligjor përkatës çdo punëtor i është llogaritur paga me 126 ditë pune.

Stafi duhet të jetë i paisur me rrobat e përshtatshme të punës me logo të Bashkisë dhe operatorit.. Tualetet gjatë përdorimit do të kenë edhe pajisje për pastrimin e tyre, të gjitha të planifikuar në analizën e kostos. Listat e punonjesve duhet të paraqiten Autoritetit Kontraktual me kërkesën e AK. Autoriteti Kontraktor realizon monitorime të realizimit të shërbimit nga ana e operatorit dhe nëse vihet re mos realizim i kritereve dhe kushteve të kontratës dypalëshe ndërmerren penalizimet përcaktuara në kontratë.

9. Pajisja e punonjësve me uniformë.

a-Kontraktori duhet të pajisë të gjithë punonjesit e vete me uniforme të njëjtë.

b-Uniforma duhet të ketë të stampuar siglën e Kontraktuesit, si dhe të Autoritetit Kontraktor. Kjo në dakortësi ndërmjet palëve.

c-Mbrenda tre muajve të fillimit të kontratës, të gjithë punonjësit duhet të jenë të pajisur me uniformën.

d-Nuk lejohet për asnjë lloj arsye që punonjesit të mos kenë të veshur uniformën e përcaktuar, në të kundërt, penalizohet.

10. Vendi i depozitimit të mbetjeve

Mbetjet urbane do të depozitohen për trajtimin përfundimtar në landfill-in e Bushatit. Landfilli i Bushatit është përcaktuar nga Qeveria Shqipëtare si destinacioni për trajtimin përfundimtar të mbetjeve urbane për të gjithë rajonin e veriut, qarqet Shkodër & Lezhë.

Kosto e depozitimit është fikse dhe do të përfshihet në ofertën financiare të ofertuesit mbi bazën e cmimit njësi aktual të depozitimit në Landfill in e Bushatit. Në preventivë zëri



depozitim i mbetjeve në lëndfillin e bushatit është i ndarë në dy zëra buxhetor, ai me cmimin e vjetër përpara njoftimit për rritjen e tarifës me 863 lekë pa tvsh dhe “diferenca shitese e rritjes të tarifës të depozitimit të mbetjeve në lëndfillin e Bushatit”, për të cilën Bashkia Shkodër ka hapur një proces gjyqësor, tarifa prej 637 lekë pa tvsh. Sqarimi është paraqitur në Këshillin Bashkiak Shkodër me mirtaimin e Buxhetit afat mesëm dhe Buxhetit vjetor, me Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.71 datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023 – 2025 të Bashkisë Shkodër”, Linku bashkëlidhur programi buxhetor 5100 “menaxhimi i mbetjeve:

https://ëëë.bashkiashkoder.gov.al/ëëb/programi_05100_5455.pdf

Nëse cmimi i depozitimit do të ndryshojë bazuar në vendimarrjen e Institucioneve ligjzbatuese apo organit Kolegjial Këshilli Bashkiak i Bashkisë Shkodër, atëherë ky ndryshim do të reflektohet në koston e këtij shërbimi në baze vjetore në zbatim të procedurave administrative përcaktuar me Ligj/VKB/ kontratë ose amendament të kontratës respektive.

10.1. Edukimi Publik Mjedisor.

Në kuadër të përmirësimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në NJA Velipojë në zonën e plazhit përgjatë 110 ditëve të sezonit turistik, Bashkia Shkodër vjen me një risi në procesin e grumbullimit të mbetjeve në mënyrë sa më eficiente dhe në përmirësimin e standartit të shërbimit. Në vitin 2022 u pilotua skenari i mbledhjes derë më derë i mbetjeve urbane në plazhin e velipojës duke e parë këtë skemë shumë të domosdoshme për këtë territor me destinacion turizmin për vetë fluksin e mbetjeve që gjeneronte që kishte kjo zonë vecanërisht zona e qendrës të plazhit të Velipojës.

Me përzgjedhjen e një prej skenarëve, realizohet minimizimi i pikave e grumbullimit në qendër të plazhit, pika të cilat gjatë gjithë kohës kanë qenë të mbi ngarkuara me mbetje, duke shkatuar kështu ndotje të plazhit dhe një ambient aspak të këndshëm për turistët që frekuentojnë plazhin e Velipojës.

Në vitin 2022, u ndoq një fushatë ndërgjegjësimit dhe u organizuan anketime për njesitë tregëtare dhe ato akomoduese. Gjithashtu me qëllim incentivimin e politikave të riciklimit u shpërndanë nëpër pedonalen e Velipojës kosha që mbledhnin vetëm shishet e plastikës nga turistët që më së shumti frekuentojnë stacionet e plazhit të zonës bregdetare me qëllim edhe zvoglimin e volumit të mbetjeve që shkon në pikat e grumbullimit, dhe për rrjedhojë uljen e tonazhit që shkon në lëndfillin e Bushatit. Me realizimin e ndarjes të plastikës dhe kartonit edhe në njesitë tregëtare të mëdha, në të gjithë territorin e plazhit, do të vijojë të bëjë të mundur uljen e tonazhit të mbetjeve që depozitohen në lëndfillin e Bushatit si edhe uljen e ngarkesës në pikat e grumbullimit. Fushata e ndërgjegjësimit kërkoi ti paraprijë procesit të riciklimit të mbetjeve të plastikës dhe kartonit në të gjithë territorin duke realizuar mbledhjen e plastikës përgjatë gjithë pedonale nga pushues të zonës veçanërisht nga ata që frekuentojnë stacionet e plazhit, dhe plazhet private e publike. E njëjta fushatë do të realizohet në vitet në vijim në muajt maj-Qershor, para përgatitjes për sezonin turistik. Vlen të theksohet që për fushtatën e ndërgjegjësimit është caktuar një kosto e vecantë në përlogaritjen e fondit limit, për operatorin sipërmarrës. Kjo fushatë do të realizohet cdo nisje të sezonit duke informuar turistët e Velipojës, njesitë tregëtare dhe ato akomoduese mbi rregulloren e menaxhimit të



mbetjeje gjatë sezonit turistik, orarin, ndarjen e mbeturinave në burim etj. Kjo do të shohet me një aktivitet publicitar i Kontraktorit, për të rritur dhe përmirësuar njohuritë e konsumatorit përsa i përket mbledhjes, përpunimit dhe largimit të mbetjeve, ndarjes së mbetjeve në burim, gjatë sezonit turistik sipas një rregulloreje të miratuar paraprakisht nga AK. Plani i punës i organizimit të fushatës ndërgjegjësuere që do të zbatohet nga ana e operatorit sipërmarrës, paraprakisht do të hartohet nga Dr.e shërbimeve publike miratohet nga Kryetari I Bashkisë dhe monitorohet nga nj.a/nj.m (sipas procedurës standarte).

10.2 Hartimi dhe rezultatet e pyetësorit.

- Rezultatet nga fushata e ndërgjegjësimit .

Eksperienca e vitit 2022 me hartimin e pyetësorit para vendimarrjes të grumbullimit të mbetjeve derë më derë kishte për qëllim të kuptohej njohja e banorëve me procesin e grumbullimit të mbetjeve derë më derë dhe gatishmërinë e tyre për të marrë pjesë në këtë skemë. Pyetësori ishte I thjeshtë me 7(shtatë) pyetje. Gjithsej u zhvilluan 50 pyetësorë në bizneset kryesore përgjatë Rrugës nr.9, Kompleksit „Fishta“ dhe zonës së plazhit (pedonalja). Kategoria mbizotëruese e bizneseve i përkiste bareve, restoranteve dhe marketeve të zonës. Nga bizneset të cilët plotësuan pyetësorin, vetëm 8/50 prej tyre nuk zotëronin pika personale të përkohshme të grumbullimit të mbetjeve dhe i depozitonin ato në pikat më të afërta të vendosura nga bashkia në anë të rrugëve. Bizneset me kosha personale në ambientet e tyre, i kishin kryesisht të kapacitetit 40 l dhe 120 l.

Rryma dominante e mbetjeve të gjeneruara nga çdo biznes i përkiste llojit a dhe b të alternativave të pyetësorit, përkatësisht mbetjet organike dhe mbetjeve të riciklueshme të thata. Kjo gjë tregon se ka hapësirë dhe për ndarje në burim të mbetjeve kryesisht në supermarkete dhe dyqane të zonës.

Përsa u përket opinioneve të administratorëve/punonjësve të bizneseve të pyetura në lidhje me problematikat e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve dhe mënyrave konkrete për përmirësimin e tij, 17/50 biznese cilësuan grumbullimin me orar si opsionin më të përshtatshëm. Bizneset në afërsi të plazhit e shihnin si më të nevojshëm shërbimin e grumbullimit derë më derë pasi do t'i ndihmonte shumë në periudhën me më shumë fluks pune.

Më shumë se gjysma e bizneseve që plotësuan pyetësorin (28/50 biznese) vlerësuan grumbullimin të paktën 2 herë në ditë të mbetjeve nga ambientet e tyre. Mëngjesi dhe darka janë periudhat e ditës që u përzgjedhën nga individët e pyetur. Mëngjesi dhe dreka ishin më në favor të restoranteve dhe gjellëtoreve. Për bizneset përgjatë vijës bregdetare (kryesisht beach bars, hotele dhe markete), orari më i përshtatshëm do të ishte ndërmjet intervalit 22:00 - 24:00.

Bazuar në përgjigjet e marra nga pyetësori dhe pas diskutimit me specialistët e bashkisë, u hartua materiali informues për t'u shërndarë në bizneset e NJA Velipojë.

Broshura e hartuar konsiston në dy faqe, ku faqja e parë paraqet oraret e përcaktuara nga bashkia për grumbullimin e mbetjeve urbane në Kompleksin „Fishta“ dhe Rrugën nr.9. Në zonën e parë, grumbullimi i mbetjeve do të bëhet derë më derë në tre oraret kryesore të ditës, ndërsa në zonën e dytë në mëngjes dhe pasdite. Faqja e dytë e fletpalosjes ka karakter informues dhe ndërgjegjësuere. Bashkia Shkodër ka shërndarë në qendrën e saj koshat metalik



për grumbullimin e shisheve plastike, duke ftuar të gjithë pushuesit dhe bizneset e zonës që të mund të respektojnë dhe ta nxisin këtë iniciativë për një ambient më të pastër. Ky është një hap promovues për procesin e riciklimit dhe ndërgjegjësimin e banorëve mbi praktika me karakter miqësor me mjedisin, pasi këto kosha do të reduktojnë sadopak volumin e mbetjeve në pikat e grumbullimit, duke u bërë shembull për të gjitha njësitë tregtare që të vendosin pranë subjekteve të tyre kosha për plastikën dhe kartonin. Pjesa përmblylëse e broshurës përmban fakte mbi plastikën dhe efektin e saj negativ në ndotjen e planetit, duke vënë theksin mbi rëndësinë dhe emergjencën e nismave ricikluese.

Të dhëna nga grumbullimi i plastikës :

Për një muaj, në muajin gusht tetë koshat e mbledhjes të plastikës të shërndarë nëpër pedonale u mbushën me 440 kg. Koshat u vendosën në pedonale pranë stacioneve të plazhit me qëllim jo vetëm ndarjen e plastikës dhe mbledhjen e disiplinuar, por edhe uljen e volumeve të koshave të rërës duke mbajtur pastër stacionet e plazhit të vijës bregdetare. U vu re një ndërgjegjësim i shtuar i frekuentuesve të plazhit të velipojës për arsye se koshat kishin vetëm shishe plastike sic edhe kërkohej nga materialet promovuese të fushatës të ndërgjegjësimit. Bashkia Shkodër është e hapur të marrë iniciativa për të mbështetur iniciativa të tilla riciklimi për plastikën/kartonat ose alumini, për njësitë tregtare dhe stacionet e plazhit.



VELIPOJA RICIKLON!

Të mbajmë plazhin pastër!

BASHKIA SHKODËR informon qytetarët dhe bizneset në NJA Velipojë – zonë e plazhit për oraret e grumbullimit të mbetjeve urbane nga pikat e grumbullimit të mbetjeve të përcaktuara nga bashkia:

- ➔ Në Kompleksin Fishta, mbetjet urbane do të grumbullohen në këto oraret:
 - Orari i mëngjesit : Mëngjes 08:00-09:00
 - Orari i drekës : 16:00-17:00
 - Orari i darkës : 00:00 - 01:00 (grumbullim deri më drete në këtë kompleks)
- ➔ Në Zonën 2, në Strugën 9 dhe përballë lufshkës, mbetjet urbane do të grumbullohen në këto orare:
 - Orari i mëngjesit : përpara orës 08:00
 - Orari i mbrastjes : pas orës 17:00




VELIPOJA RICIKLON!

BASHKIA SHKODËR fton qytetarët, bizneset dhe turistët që të hedhin **SHISHET PLASTIKE** në kontenerët e shpërndarë nga bashkia përgjatë pedonale në zonën qendrore në **VELIPOJË!**



1.F. DIVI SE!

- ➔ **Plastika** si një material me prejardhje nga njeriu, u shpik për herë të parë në vitin **1907**
- ➔ **Shisheet plastike** duan deri në **450 vite** për t'u shpërbërë
- ➔ **90% e kostax të shisheve të ujit është vetë shishja plastike**
- ➔ **1/3 e mbetjeve të plastikës** në dete dhe oqeanë përbëhet nga shisheet plastike
- ➔ Rreth **40% e plastikës** sot përdoret vetëm **1 herë** dhe më pas hidhet
- ➔ Rreth **5 trillon copa plastike** gjenden sot në oqeanë dhe dete





Koshat e shpërndarë për mbledhjen e shisheve të plastikës përgjatë gjithë pedonales të Plazhit të Velipojës.





Neni 12


Lejet dhe Licensat

16.2 Kontraktuesi ka përgjegjësi për sigurimin e lejeve, liçensave dhe autorizimeve sipas e në përputhje me kërkesat ligjore të Republikës së Shqipërisë, për të zbatuar Shërbimin, veç rastit kur Palët bien dakord ndryshe.

Neni 13

Heqja dhe zëvendësimi i personelit kryesor

- 17.1 Kontraktuesi duhet të informojë me shkrim Autoritetin Kontraktues Bashkia Shkodër, në rast të heqjes ose zëvendësimit të personelit kryesor siç propozohet në ofertën e Kontraktuesit.
- 17.2 Kontraktuesi zëvendëson çdo punonjës, nëse Autoriteti Kontraktues Bashkia Shkodër evidenton se personi ka kryer veprime të kundërligjshme ose Autoriteti Kontraktues vlerëson se performanca e personelit është e pakënaqshme.
- 17.3 Nëse lind nevoja për zëvendësimin e një apo më shumë personave që bëjnë pjesë në personelin kryesor, Kontraktuesi duhet të sigurojë që zëvendësuesi është me kualifikime ekuivalente ose më të mira.
- 17.4 Kontraktuesi duhet të paguaje çdo kosto shtesë në rast të zëvendësimit të personelit të tij, me përjashtim të rasteve kur shkak i zëvendësimit ka ardhur si përgjegjësi e Autoritetit Kontraktues, jashtë kontrollit të Kontraktuesit.
- 17.5 Kontraktuesi duhet të sigurojë që pagat e punonjësve të tij janë në përputhje me të gjitha dispozitat ligjore në fuqi të Republikës së Shqipërisë.
- 17.6 Të gjithë drejtuesit e të gjitha llojeve të automjeteve dhe kamioneve të Kontraktuesit, duhet të jenë të kualifikuar për qëllimet e Shërbimit dhe duhet të kenë Leje të vlefshme drejtimi lëshuar nga Republika e Shqipërisë me kategorinë përkatëse. Kontraktuesi ka përgjegjësinë të ndalojë dhe kontrollojë konsumin e alkoolit përpara dhe gjatë oreve të punës, si për drejtuesit e mjeteve dhe punonjësve. Perfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor janë të lejuar të kontrollojnë në çdo orë të punës për nivelin e alkoolit të punonjësve të Kontraktuesit dhe në rastet e përsëritjes së praktikave të këqija të zbatojë pikën 2 të këtij neni.
- 17.7 Kontraktuesi duhet të fillojë kurse specializimi (trajnojë) për të gjithë punonjësit e tij që do të angazhohen në kryerjen e shërbimeve për mbledhjen e mbeturinave të ngurta, në mënyrë që të jenë në gjëndje të dallojnë mbeturinat e rrezikshme, të infektuara dhe të papranueshme, të jenë të vemendshëm dhe të zbatojnë rregullat e sigurisë dhe të ndjekin praktikatat e mira.
- 17.8 Kontraktuesi duhet të pajisë të gjithë punonjësit me uniforma sigurie dhe me shenja dalluese (badge) me emrat e Kontraktuesit dhe të Autoritetit Kontraktor.
- 17.9 Kontraktuesi nuk duhet të lejojë punonjësit e tij të përfitojnë, të nxisin, ose të kërkojnë pagesë shtesë nga operatorë privatë, ose publikë për largimin e mbeturinave urbane dhe jo urbane. Punonjësit e Kontraktuesit nuk do të lejohen të seleksionojnë mbetjet dhe të shesin materialet e ricikluara për interes të tij gjatë orarit të punës.



17.10 Kontraktuesi duhet të pajisë të gjitha mjetet dhe paisjet me të gjitha karakteristikat dhe shenjat dalluese të Kontraktuesit ashtu siç përcaktohet në "Specifikimet Teknike".

17.11 Kontraktuesi është i detyruar të caktojë një Drejtor Teknik për këtë Kontratë. Drejtuesi teknik i shërbimit është personi që Kontraktuesi ka propozuar në ofertën e tij. Drejtuesi Teknik për Shërbimin është: **Ing.Todi Buzo**
rejshpk99@yahoo.com Telefon: 0682052610

Detyrat kryesore të Drejtuesit Teknik janë si më poshtë:

- i. Ai është përgjegjës përpara Autoritetit Kontraktor për zbatimin e shërbimit të pastrimit në përputhje me kontratën dhe përmbajtjen e saj.
- ii. Mbajtjen e dokumentacionit teknik të detyrueshëm.
- iii. Ndjekjen e performancës së shërbimit të pastrimit në përputhje me plan-organizimin e miratuar dhe grafikun e shërbimit.

17.12 Në rast se ndryshohet Drejtuesi Teknik i shërbimit, Kontraktuesi duhet të lajmërojë me shkrim Autoritetin Kontraktor dhe të ndjeke procedurën e parashikuar në pikën 3 të këtij.

17.13 Drejtuesi i ri Teknik duhet të ketë të gjitha kualifikimet e kërkuara në dokumentat e tenderit për Drejtuesin Teknik. Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkodër mund të kundërshtojë emërimin e Drejtuesit Teknik nëse vlerëson se ai nuk përmbush kualifikimet e përcaktuara në Dokumentat e Tenderit. Në këtë rast Kontraktuesi duhet të propozojë dhe caktojë një Drejtues Teknik tjetër pas marrjes së miratimit të nevojshëm nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 18 **Vendndodhja**

Shërbimet duhet të kryhen në zonën e shërbimit të Kontratës siç është e përcaktuar në specifikimet teknike.

Neni 19 **Siguracioni i përgjegjësisë profesionale**

19.1 Kontraktuesi duhet të garantojë me Policë për sigurimin e përgjegjësisë profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithësi për profesionin, për ta zhdëmtuar Autoritetin Kontraktues për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e shërbimeve.

19.2 Nëse nuk është përcaktuar në kontratë shuma minimale e siguracionit, Kontraktuesi duhet të sigurojë siguracion në shumën e njohur në përgjithësi si të mjaftueshme nën rrethanat e shërbimeve që po sigurohen.

19.3 Kontraktuesi duhet të sigurohet pranë një shoqërie sigurimi me emra të përbashkët të Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit, nga data e hyrjes në fuqi të kontratës deri në datën e perfundimit të plotë të shërbimit të pastrimit. Sigurimi do të kryhet për humbje ose dëmtim të pajisjeve, materialeve; humbje ose dëmtim të pronave dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta.

19.4 Rregulloret për çertifikatat e siguracionit do t'i dorëzohen mbikqyrësit për aprovim pas nënshkrimit të kontratës. ~~Siguracioni duhet të mbulojë kompensimin e kërkuar për të~~



kompensuar humbjen ose dëmin e shkaktuar. Nëse kontraktuesi nuk siguron certifikatat e kërkuara të siguracionit, kontrata konsiderohet e anuluar. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të zëvendësojë, të zgjasë periudhen e paraqitjes së certifikatave të siguracionit ose të kryejë vete pagesën për policën e sigurimit të përgjegjësive profesionale dhe të zbresë kostot e saj nga pagesa që i detyrohet Kontraktuesit.

19.5 Ndryshime në afatet e siguracionit nuk mund të bëhen pa aprovimin me shkrim të Autoritetit Kontraktor, Bashkisë Shkodër.

Neni 20

Mbeturina të rrezikshme

20.1 Përfaqësuesit e Kontraktuesit (të punësuarit e tij), kur konstatojnë praninë e çdo mbeturine të papranueshme brenda dhe jashtë kontenierit, duhet të lajmërojnë Autoritetin Kontraktor, Bashkinë Shkodër për këto mbeturina toksike, infektive ose të rrezikshme në mënyrë që bashkërisht të marrin masa për largimin e tyre. Në këto raste të dyja palët kallëzojnë pranë organeve kompetente për ndjekjen ligjore të shkaktarit.

Neni 21

Kontakti me publikun

21.1 Kontraktuesi duhet të mbajë një zyrë brenda juridiksionit të Autoritetit Kontraktor Bashkisë Shkodër, me qëllim që të komunikojë me Autoritetin Kontraktor dhe publikun në përputhje me "Specifikimet teknike". Kontraktuesi është i detyruar të vendosë dhe komunikojë një numër telefoni dhe një adresë emaili për publikun. Këto kërkesa duhet të komunikohen Autoritetit Kontraktor brenda 1 (një) muaji nga firmosja e Kontratës.

Neni 22

Edukimi publik mjedisor

22.1 Kontraktuesi duhet të zhvillojë një Program të Edukimit Publik Mjedisor të destinuar për të përmirësuar njohuritë e konsumatorëve dhe banorëve të qytetit të Shkodrës për të rritur në maksimum pjesëmarrjen në programin e menaxhimit të mbeturinave duke vendosur theksin në grumbullimin e tyre në kontenierë, fshirjen e rrugëve dhe respektimin e orareve përkatëse. Ky program edukimi do të kryhet nga Kontraktuesi në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktor Bashkinë Shkodër duke shfrytëzuar të gjitha mjetet e komunikimit masiv.

22.3 Kontraktuesi duhet të prodhojë dhe të shpërndajë materialin informativ të shkruar një herë në tre muaj, me broshura ose fletë - palosje që pasqyrojnë idetë dhe formatin sipas idesë dhe përcaktimeve që do t'i jepen nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkodër.

22.4 Autoriteti Kontraktor i njofton Kontraktuesit kohën dhe afatin në të cilin do të realizohet dhe materiali informativ i shkruar, broshura ose fletë-palosja.

Neni 23

Taksat dhe tarifat

23. Kontraktuesi është i detyruar të paguajë të gjitha taksat dhe tarifat në përputhje me legjislacionin në fuqi.



Neni 24

Kontenierët, mjediset dhe paisjet

- 24.1 Autoriteti Kontraktor, Bashkia Shkodër përcakton Pikat e Grumbullimit të Mbeturave dhe numrin e konteniereve për secilën pikë në zonën e Kontratës sipas preventivit, në specifikimet teknike, sipas listës së rrugëve dhe hartë, në përputhje me Planin Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane, Bashkia Shkodër 2017. Kontenierët do të mbeten pronë e Autoritetit Kontraktor, Bashkia Shkodër.
- 24.2 Kontraktuesi do të marrë në dorëzim kontenieret nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Shkodër, me anë të procesverbaleve të mbajtur e firmosur nga përfaqësuesit e secilës palë. Procesverbalet do të përmbajnë numrin e kontenierëve, pikat e vend grumbullimit ku do të vendosen kontenierët, gjendjen e kontenierëve, barkodin apo të dhëna të tjera që ndihmojnë në identifikimin e konteniereve.
- 24.3 Kostot e transportit të kontenierëve nga magazina deri në pikat e përcaktuara të grumbullimit do të përballohen nga Kontraktuesi.
- 24.4 Kontraktuesi ka përgjegjësi për ruajtjen, menaxhimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e kontenierëve, kur këta të fundit dëmtohen për çdo shkak. Kontraktuesi merr përsiper riparimin e të gjitha dëmtimeve dhe duhet të sigurojë një vendpune dhe furnizimin me pjesët e këmbimit.
- 24.5 Kontraktuesi ka përgjegjësi për larjen dhe dizinfektimin e kontenierëve në përputhje me Specifikimet Teknike.
- 24.6 Në rast të dëmtimit të kontenierit, Kontraktuesi do ta zëvendësojë atë menjëherë me kontenierin rrezervë të rregullt dhe të rregullojë kontenierin e dëmtuar.
- 24.7 Në rastin e humbjes ose vjedhjes së kontenierëve, Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për zëvendësimin fizik të kontenierëve ose pagesën e vlerës së kontenierëve.
- 24.8 Autoriteti Kontraktor, Bashkia Shkodër, i përcakton Kontraktuesit vëndin e depozitimit të mbeturave urbane. Kontraktuesi është përgjegjës për të siguruar dhe menaxhuar një vendodhje për inertet dhe mbetjet nga ndertimi. Kostoja për këtë shërbim do të mbliidhet direkt nga prodhuesit e mbetjeve me një tarife të përcaktuar në bashkepunim me Bashkinë në mënyrë që të merret kostoja e plotë.
- 24.9 Kontraktuesi, duhet të vendosë një numër rendor identifikimi për verifikim dhe shënimin e të dhënave nga monitoruesit për secilin kontenier ose një barkod, i cili do të mundësojë leximin e kodit IQ, në mënyrë që të dhënat për secilin kontenier, të lexohen dhe regjistrohen elektronikisht në sistemin elektronik të monitorimit. Kjo e fundit kur AK të sigurojë aplikacionin perkates.
- 24.10 Kontenierët gjatë gjithë periudhës së shërbimit, dhe në të gjithë zonën e Kontratës duhet të jenë me shenja të dukshme identifikuese për sigurinë gjatë natës.
- 24.11 Sipermarresi I shërbimit është i detyruar të zëvendësojë në mënyrë progressive 15 % të periudhës të kontraktuar.

Neni 25

Detyrime të Autoritetit Kontraktor, Bashkia Shkodër

25.1 Autoriteti Kontraktor informon në mënyrë periodike banorët nëpërmjet lajmerimeve



- zyrtare ose mediave të shkruara dhe elektronike rreth mbajtjes pastër të ambjentit.
- 25.2 Depozitimi i mbetjeve urbane dhe jo urbane do të kryhet gjatë 7 ditëve të javës. Autoriteti Kontraktor merr përsipër sistemimin e ambjenteve ku do të vendosen kontenerët për të mundësuar kryerjen e shërbimit.
- 25.3 Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkodër, duhet të kryejë pagesën për shërbimet e kryera nga ana e Kontraktuesit në përputhje me kushtet e kësaj kontratë, pas zbritjes së penalteteve për mos ofrimin, ofrimin e keq dhe të pamjaftueshem të shërbimit.

Neni 26

Mbikqyrja e shërbimit

- 26.1 Monitoruesit e caktuar nga Autoriteti Kontraktor sipas procedurës standarte të veprimit për administrimin e shërbimit të pastrimit të miratuar, dhe Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Shkodër mbikqyrin drejt për drejt procesin e monitorimit duke plotësuar formatet e raportimit të shërbimit të pastrimit dhe duke plotësuar dokumentacionin përkatës sipas Procedurës standarte, rregulloreve etj.
- 26.2 Specialistës/monitorues në zbatim të procedurës standarte plotësojnë procesverbalet dhe raportet ditore/mujore për punë kryer ose të pa kryer mbi cilësinë dhe masën e kryerjes së shërbimit.
- 26.3 Situacionet mujore vendosen në sasi sipas cdo zeri shërbimi të shprehur në lekë në përputhje me raportimet ditore nga njësitë administrative process verbalet dhe raportet ditore/mujore për shërbimin e kryer/të pa kryer dhe preventivin e kësaj kontratë.
- 26.4 Situacionet hartohen nga specialisti i Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër, bazuar në procesin e monitorimit dhe kontrollit të shërbimit, të përcaktuar në Procedurën Standarte. Kontrolli i kryerjes së shërbimit të pastrimit do të kryhet në vendin dhe kohën e përcaktuar në grafik sipas formateve të monitorim-raportimit.
- 26.5 Situacionet mujore do të hartohen në bazë të proces-verbaleve dhe raportimeve të nënshkruara nga të dyja palët.
- 26.6 Situacionet që nuk pranohen të nënshkruhen nga përfaqësuesi i Kontraktuesit marrin vlerë dhe pa nënshkrimin e tij në këto raste:
- Kur përfaqësuesi i Kontraktuesit nuk është prezent në kontrollin e punës sipas grafikut.
 - Drejtuesi Teknik i Kontraktuesit, pas njoftimit nga Mbikqyrësi i shërbimit, duhet të paraqesë prova lidhur me konstatimet e bërë nga Mbikqyrësi I shërbimit, në të kundërt konstatimet e Mbikqyrësit konsiderohen të mirëqëna.
- 26.7 Mbikqyrësit kur konstatojnë shërbim të pakryer/mospërbushje të detyrime kontraktuale, dokumenton rastet, informon njëkohësisht Autoritetin Kontraktor dhe Kontraktuesin, dhe më pas vendos sanksionet e parashikuara në këtë kontratë.

Neni 27

Monitorimi i shërbimit

- 27.1 Autoritetit Kontaktor, në zbatim të Procedurës standarte të veprimit për administrimin e pastrimit të miratuar ka përcaktuar grupin e monitorimit duke nisur nga monitoruesi monitoruesi ditore i shërbimit të pastrimit inspektorët e njërive administrative sipas



zonave të shërbimit të kësaj kontrate, deri tek specialist monitorues i njësisë të monitorimit të shërbimeve publike i cili i bëhet i ditur kontraktuesit në zbatim të kësaj kontrate dhe procedurës standarte, prgjegjësi i njësisë dhe Drejtori I Drejtorisë të Shërbimeve Publike në respektim të shkallës hirearkike.

- 27.2 Grupi i monitorimit ka përgjegjësi për monitorimin e cilësisë dhe sasisë të shërbimit në territorin e mbuluar në zbatim të kësaj kontrate.
- 27.3 Grupi i monitorimit verifikon kryerjen e shërbimit sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në prokurimin publik, raporton çdo ditë pranë autoritetit kontraktor dhe ndjek rregullat e përcaktuara në procedurën standarte.
- 27.4 Grupi i monitorimit identifikon nevojat specifike dhe bën propozimet tek autoriteti kontraktor.
- 27.4 Për një monitorim më të saktë direkt nga nga njësia e monitorimit kontraktuesit i kërkohet të vendosë kamera në cdo mjet pastrimi, në pjesën e pasme të mjetit ku realizohet tërheqja e mbetjeve nga kazanët. Kamerat duhet të lidhen me një sistem që transmetojnë realizimin e shërbimit në kohë reale me të cilin bashkia ka akses monitorimi. Kamerat nuk duhet të shkëputen asnjëherë nga funksioni përndryshe merren masa me penalitet.
- 27.5 Kryetari i Bashkisë krijon sipas nevojave task forcë ose grup monitorues të përkohshëm me një urdhër të vecantë në funksion të përmirësimit të shërbimit të pastrimit dhe marrjen e masave përkatëse për rritjen e performancës të shërbimit .

Neni 28

Vlera totale e kontratës dhe çmimi i kontratës

“Vlera Totale e Kontratës”, nënkupton vlerën e pranuar nga Autoriteti Kontraktor për zbatimin dhe përmbushjen e Shërbimit.

“Çmim Kontratë”, nënkupton vlerën për tu paguar nga Autoriteti Kontraktues për zbatimin dhe përmbushjen nga ana e Kontraktuesit të shërbimeve dhe përmbushjes së të gjitha detyrimeve kontraktuale dhe ligjore të lidhura me këtë Kontratë.

Neni 29

Afatet e pagesës

- 29.1 Pagesat e faturave të Kontraktuesit (certifikatat e pageses, situacionet), si edhe çdo pagesë paraprake, të paguhen në kohë siç specifikohet në Kontratë.
- 29.2 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i këmbimit të monedhës së huaj do të jetë kursi i Bankës së Shqipërisë në ditën kur është dërguar njoftimi i Kontratës për botim.
- 29.3 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në Kontratë, kërkesa e Kontraktuesit për pagesë duhet t'i bëhet Autoriteti Kontraktues Bashkisë Shkodër me shkrim. Për çdo kërkesë, Kontraktuesi duhet të paraqesë origjinalet dhe kopjet e saj, së bashku me një listë të sendeve që përshkruan Shërbimet e kryera të cilat janë të listuar në Preventiv.



29.4 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në Kontratë, pagesa për Shërbimet bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e marrjes së kërkesës për pagesë, bashkë me faturën tatimore.

29.5 Data e pagesës do të jetë data kur fondet debitoen nga llogaria e Autoritetit Kontraktues Bashkisë Shkodër.



Neni 30

Vonesa në bërjen e pagesës


30.1 Në rast të vonesave në kryerjen e pagesave nga ana e Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër, megjithëse Kontraktuesi ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij me kushtet e Kontratës, Kontraktuesi do të ketë të drejtë të marrë detyrimet e prapambetura dhe kamatë vonesat përkatëse gjatë periudhës së vonesës në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”.

Neni 31


Ndalesat për mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale

Kontraktuesi do t'i nënshtrohet ndalesave nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Shkodër, si më poshtë vijon:

- 1- Për mospërmbushje të detyrimit për **“Mbledhje grumbullim dhe transport i mbetjeve urbane”**, kur konstatohen rastet:
 - a. **Kontenier i pa evaduar:** Në rastin e konstatimit të punës të pa kryer sipas specifikimeve teknike dhe grafikut, kontraktuesi penalizohet me 5000 (pesë mijë) lekë për çdo kontenier të pa evaduar ditor.
 - b. **Pikë Grumbullimi Mbeturinash e pa pastruar, mbetje në tokë, në një rreze deri në 5m nga të gjitha anët e pikës së grumbullimit:** Kontraktuesi penalizohet në masën 5000 (pesë mijë) lekë për çdo pikë grumbullimi mbetjesh të papastruar ditor.
 - c. **Gjatë transportit të mbetjeve urbane, konstatohet që mjeti teknologjik ka rrjedhje vajrash apo lëngjesh nga kazani i makinerisë:** Kontraktuesi penalizohet në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për raste të konstatuara.
- 2- Për mospërmbushje të detyrimit **“Për realizimin e skemës të grumbullimit derë më derë”** : Kontraktuesi do të penalizohet 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;
- 3- Për mospërmbushje të detyrimit për **“Dezifektim të pikës grumbullimit mbetjeve”**, kur konstatohet se:
 - a. **Pikë Grumbullimi Mbetjesh e padizefektuar sipas grafikut:** Kontraktuesi penalizohet në masën 5000 (pesë mijë) lekë për pikë grumbullimi mbetjesh.
- 4- Për mospërmbushje të detyrimit për **“Menaxhim dhe mirëmbajtje kontenierësh”** kur konstatohen rastet:
 - a. **Kontenier i pa larë:** Kontraktuesi penalizohet në masën 5000 (pesë mijë) lekë për çdo kontenier të pa larë.
 - b. **Kontenier i dëmtuar:** Per çdo kontenier të dëmtuar, (rrota të hequra, deformime mekanike, lyerje me boje, etj.) i cili nuk rregullohet brenda 5-ditëve të lajmërimit



- nga Autoriteti Kontraktor, kontraktuesi penalizohet në masën 5000 (pesë mijë) lekë për çdo kontenier të pa riparuar.
- 5- Për mospërbushje të detyrimit për **“Fshirje manuale e rrugëve, pedonale dhe trotuareve”**, kur konstatohen rastet:
- Rrugë, pedonale dhe trotuar të pafshirë manualisht:** kontraktuesi do të penalizohet për sipërfaqen e pafshire me 5 (pesë) fish-in e çmimit të zërit përkatës të preventivit.
 - Gjatë procesit të fshirjes manuale të rrugëve, pedonale dhe trotuareve, konstatohet se punonjësit e shërbimit të pastrimit, hedhin mbetje në vende të palejuara, në sistemin e kanalizimeve apo të burimeve ujore:** Kontraktuesi penalizohet në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për çdo rast të konstatuar dhe duhet të pastroje vendin me kosto të tij.
- 6- Për mospërbushje të detyrimit për **“Depozitim i mbetjeve urbane në Landfill”**, kur konstatohet:
- Mosdepozitim i mbetjeve urbane në landfill:** Kontraktuesi do të penalizohet në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë për çdo rast të konstatuar për hedhjen e mbeturinave në vend të pa autorizuar.
- 7- Për mospërbushje të detyrimit për **“Pajisjen e punonjësve me uniforma sigurie dhe me mjetet e sigurimit teknik”**, kur konstatohet se:
- Punonjësit nuk janë pajisur me uniforma dhe me mjetet e sigurimit teknik, sipas specifikimeve teknike:** Kontraktuesi do të penalizohet në masën 5000 (pesë mijë) lekë për çdo punonjës të konstatuar. Masa e penaltetit do të mbahet nga situacioni pasardhës që do të paraqitet për likuidim.
- 8- Për mospërbushje të detyrimit **“të të pasurit në punë çdo ditë të numrit të mjeteve teknologjike”**, kur konstatohet se:
- Nuk punojnë çdo ditë të gjitha mjetet teknologjike sipas specifikimeve teknike dhe grafikeve të punëve,** gje që sjell mosrespektim të frekuencave dhe të orareve të kryerjes së shërbimeve, Kontraktuesi do të penalizohet në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lek për çdo mjet të munguar.
- 9- Për mospërbushje të detyrimit **“të prezencës në punë të numrit të punonjësve”** kur konstatohet se nuk është prezenca e plotë e punonjësve sipas specifikimeve dhe grafikeve ditore, Kontraktuesi do të penalizohet në masen 5000 (pesë mijë) lek për çdo punonjës të munguar.
- 10- Nëse nuk realizohet puna e caktuar **“ E mirmbajtjes të zonës të plazhit /rërës para fillimit të sezonit tursitik, dhe mbas mbylljes të sezonit për 21 ditë , dhe “ mirmbajtja e zonës të rërës përgjatë sezonit turistik”** : Kontraktuesi do të penalizohet në masen 20 000 (njëzet mijë) lek për cdo konstatim të punës të pakryer.
- 11- Nëse nuk realizohet mirmbajtja e PGM’ve përcaktuar për sezonin turistik dhe konstatohet kjo punë e pa kryer nga operatori: Kontraktuesi do të penalizohet në masën 5000 (pesë mijë) lekë për cdo PGM’të pa mirembajtur.
- 12- Nëse konstatohet WC publike e pa mirmbajtur e ndotur dhe pa punëtor të pranishëm në vendin e punës sipas specifikimeve teknike: Kontraktuesi penalizohet me 10 000 (dhjetë mijë) lekë për cdo WC Publike të pa mirembajtur.



13- Kur konstatohet se kontraktuesi ka fikur sistemin e GPS të mjetëve teknologjike, gjatë procesit të grumbullimit dhe transportit për në lehtësim të mbetjeve urbane dhe jo urbane si dhe mjetet e tjera teknologjike sipas specifikimeve teknike: Kontraktuesi do të penalizohet në masën 100 000 lekë në qind mijë lekë për cdo rast të konstatuar. Kontraktuesi do të gjobitet me të njëjtën vlerë në rastin kur ai nuk ofron të dhënat e kërkuara për raportim, supervizim dhe llogaritje. Masa e penalitetit do të mbahet nga situacioni pasardhës që do të paraqitet për likuidim.

14- Penalitetet dhe gjobat e aplikuara sipas kësaj Kontratë, nuk përjashtojnë masat e tjera penalizuese, që mund të aplikohen nga Institucione të tjera të parashikuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

15- Çdo tentativë ose praktikë për të influencuar rezultatin e monitorimit të cilësisë së shërbimit dhe sasive me kercënim apo avantazhe ndaj grupit të monitorimit, familjes apo miqve do të penalizohet me 20 % ulje të preventivit mujor kur vendimi merret nga Bashkia. Këto praktika korruptive do t'i japin Bashkisë të drejtën për të ndaluar Kontratën për një periudhë prej 6 muajsh dhe të iniciojë procedim penal.

Neni 32

Ndryshimi i ligjeve dhe rregulloreve

32.1 Nëse, pas datës së dorëzimit të ofertave, ose datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj ose akt nënligjor në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi ose ndryshon dhe ndikon në kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

32.1 Nëse çmimi i depozitimit do të ndryshojë, atëherë ky ndryshim do të reflektohet në koston e këtij shërbimi në baze vjetore.

Neni 33

Forca Madhore

33.1 Kontraktuesi nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e depozitës së kontratës, dëmet e likuiduara, ose ndërprerjen, për mosplotësim, nëse dhe deri në masën që vonesa, në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas Kontratës, vijnë si rezultat i ndodhjes së Forcës Madhore.

33.2 Për qëllimet e këtij neni, "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje e paparashikueshme jashtë kontrollit të Kontraktuesit mbi fajin ose neglizhimin. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e Autoritetit Kontraktor Bashkisë Shkodër, qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

33.3 Nëse ndodhet në situatë të Forcës Madhore, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktues Bashkinë Shkodër. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktues jep direktiva të ndryshme, Kontraktuesi duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.



Neni 34

Vonesa në zbatim dhe zgjatja e afatit

- 34.1 Kontraktuesi duhet të fillojë zbatimin e Kontratës sikurse përcaktohet në nenin 4.
- 34.2 Me përjashtim të rastit kur Autoriteti Kontraktues është dakord për zgjatje të afateve të Kontratës, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të likuidojë dëmet për vonesën në zbatim nëse Kontraktuesi dështon në kryerjen e Shërbimeve brenda periudhës së Kontratës.
- 34.3 Autoriteti Kontraktues mund të zbrisë shumën e dëmeve të likuiduara që duhet paguar nga shumën e pagesës ndaj Kontraktuesit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktues duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.
- 34.4 Autoriteti Kontraktues do të jetë dakort për një zgjatje të afatit në rastin e Forcës Madhore.
- 34.5 Autoriteti Kontraktues mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera kur një gjë e tillë është në interesin publik. Në rast se Kontraktuesi ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktor Bashkinë Shkodër, me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të përfundimit të Shërbimeve. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakord me vonesën, zgjatja e afatit do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi.

Neni 35


Siguracioni i Punonjësve

- 35.1 Kontraktuesi përgjigjet për punësimin dhe sigurimin e nëpunësve dhe punonjësve, sipas legjislacionit në fuqi. Kontraktuesi duhet të paraqesë një numër punonjësish jo më të vogël se numri i punonjësve të deklaruar në ofertën e tij. Kontraktuesi duhet t'i paraqesë Autoritetit kontraktor, çdo 6 (gjashtë) muaj, me datë 10 janar dhe 10 korrik, listën e të gjithë punonjësve të siguruar dhe të vërtetuar nga organi kompetent, si dhe çdo informacion tjetër të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkodër në lidhje me punonjësit e Kontraktuesit.

Neni 36

Negociatat dhe amendamentet

- 36.1 Palët nuk do të negociojnë amendime ose ndryshojnë asnjë pjesë të Kontratës, që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së Kontraktuesit.
- 36.2 Asnjë amendament ose variacion tjetër i Kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, t'i referohet shprehimisht Kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktor.
- 36.3 Çdo heqje dorë nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga Palët sipas Kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe kushtet në të cilën ajo lëshohet.



Neni 37

Ndryshimi i porosisë

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën e tij të porosisë për shërbime shtesë deri në një sasi që nuk i kalon 20% të çmimit total të kontratës. Çdo porosi shtesë duhet të bëhet në mënyrë konsistente me rregullat dhe procedurat e parashikuara në Ligjin mbi Prokurimin Publik.



Neni 38

Ndërprerja për mosplotësim

38.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:

- a) Kontraktuesi dështon të kryejë Shërbimet brenda periudhës së specifikuar në Kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë.
- b) Kontraktuesi dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

38.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mospërbushjedhe t'i japi Kontraktuesit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime korruptive ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

Neni 39

Ndërprerja për shkak të falimentimit

39.1 Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkodër, mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë, nëse Kontraktuesi falimenton ose bëhet i paafte të paguajë.

39.2 Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkodër, duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

Neni 40

Ndërprerja për shkak të interesit publik

40.1 Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkodër, mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

40.2 Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkodër, duhet t'i japi Kontraktuesit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.

40.3 Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkodër, duhet të paguajë Kontraktuesin për të gjitha shërbimet e kryera përpara ndërprerjes, dhe duhet t'i paguajë Kontraktuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjeshme të shërbimeve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Kontraktuesi do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

Neni 41

Prishja e kontratës

41.1 Në rast të shkeljeve të dispozitave të kësaj Kontratë, Pala shkelëse, është e detyruar t'i rregullojë ato. Palës shkelëse i ngarkohen shpenzimet e rregullimit të këtyre shkeljeve.



41.2 Me konstatimin e shkeljeve të kushteve të kontratës, Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkodër, i bën njoftim me shkrim Kontraktuesit për konstatimin dhe detyrimin e Kontraktuesit për rregullimin e tyre brenda 3 (tre) ditëve kalendarike.

41.3 Shkeljet sipas kushteve themelore të kontratës përfshijnë por nuk kufizohen në sa vijon:

- a. Nëse Kontraktuesi nuk kryen shërbimin e pastrimit në një pjesë të zonës së kontratës apo dhe të gjithë zonen së kontratës, për një periudhë të pandërprerë prej 7 (shtatë) ditësh me përjashtim të përcaktimeve në nenin 33 të kësaj Kontratë.
- b. Nëse masa e shërbimit të pakryer dhe e penaliteteve të aplikuara tejkalon 15 % e vlerës vjetore të kontratës.
- c. Nëse Kontraktuesi falimenton ose fillon likuidimin për arsye të tjera përveç rindërtimit ose bashkimit.
- d. Nëse Kontraktuesi nuk ka në dispozicion dhe gjendje pune, apo ndryshon gjatë kohëzgjatjes së kontratës automjetet e kërkuara sipas Specifikimeve Teknike dhe të paraqitura nga Kontraktuesi në ofertë pa miratimin paraprak të Autoritetit Kontraktor Bashkisë Shkodër.

41.4 Nëse Kontrata për shkak të shkeljeve priset, atëherë Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër i lindin këto të drejta:

- a. E drejta për të deklaruar Kontratën të prishur, duke i dhënë Kontraktuesit një njoftim me shkrim brenda një afati prej 30 (tridhjetë) ditësh që nga momenti i konstatimit të shkeljeve sipas kushteve themelore të kontratës, me argumentat përkatëse. Në qoftëse kontrata priset, Kontraktuesi detyrohet të kryejë Shërbimin e pastrimit për një periudhë prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga dita e njoftimit të prishjes së Kontratës. Për këtë kohë, Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkodër është e detyruar të kryejë pagesën e Shërbimeve.
- b. Autoriteti Kontraktor, Bashkia Shkodër, ka të drejtën të sekuestrojë garancinë e kontratës të ngurtësuar në masën e përcaktuar në kontratë.
- c. Autoriteti Kontraktor, Bashkia Shkodër ka të drejtën që t'i kërkojë dëmshpërblim Kontraktuesit në masën e dëmit të shkaktuar.

Neni 42

Transferimi i të Drejtave

42. Kontraktuesi nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak i Autoritetit Kontraktor Bashkisë Shkodër.

Neni 43

Sigurimi i kontratës

43.1 Përpara nënshkrimit të Kontratës, Kontraktuesi duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor Bashkisë Shkodër, sigurimin e kontratës në shumën dhe formën e kërkuar.

43.2 Shuma e sigurimit të kontratës duhet t'i paguhet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Shkodër, si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Kontraktuesit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.



43.3 Sigurimi i kontratës do t'i kthehet Kontraktuesit jo më vonë se 30 ditë pas datës së kryerjes së Shërbimeve.

Neni 44

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

44.1 Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkodër dhe Kontraktuesi, duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrëveshje me negociata direkte.

44.2 Nëse Palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, problemet do të konsiderohen me anë të zgjidhjes së marrëveshjeve sipas Kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 45

Përfaqësimi i Palëve

45.1 Çdo Palë duhet të emërojë me shkrim një person ose post organizativ, që do të jetë përfaqësues, në emër të Palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e Palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e Kontratës.

a) Përfaqësuesi i **Autoritetit Kontraktor** Bashkia Shkodër, për ndjekjen e realizimit të Shërbimit dhe përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës do të jetë:

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Ndjekjes se Investimeve te Infrastruktures
cel/tel/fax _____

E-mail: sherbimetpublike@bashkiashkoder.gov.al

b) Personi që do të jetë përfaqësues në emër të **Kontraktuesit** për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës do të jetë

Ing. Todi Buzo.

E-Mail: rejshpk99@yahoo.com Telefon: 0682052610

45.2 Secila Palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e Përfaqësuesit të Palës. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marrë përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.

45.3 Palët mund të emërojnë persona ose njësi organizative shtesë, për të përfaqësuar Palën në veprime ose veprimtari të veçanta njoftimi me shkrim, në të cilin rast duhet dhënë dhe duhet të përcaktojë shtrirjen e autoritetit të Përfaqësuesit.

45.4 Administratori i Kontratës vë në dijeni Titullarin e Autoritetit Kontraktor Bashkisë Shkodër, për çdo rast e çështje dhe nuk mund t'i drejtohet Kontraktuesit pa marrë më parë miratimin e Titullarit të Autoritetit Kontraktor.

45.5 Në zbatim të VKM nr. 285, dt. 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", kreu XIII, neni 107, pika 6, "Zbatimi dhe mbikqyerja e kontratës", në përfundim të kontratës, **Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Ndjekjes së Investimeve të Infrastruktures, Njësia e Monitorimit te Sherbimeve Publike** si struktura që do të jetë përgjegjës, në emër të Autoritetit Kontraktor për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.



- a) harton e ndjek ecurinë e planit të zbatimit të kontratës;
- b) kryen monitorimin e zbatimit të detyrimeve të palëve në kontratë, në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë;
- c) administron dhe verifikon dokumentacionin e dorëzuar nga kontraktori, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- ç) sigurohet për kontrollin real e ligjor të kostove, cilësisë dhe afateve, kur është rasti;
- d) menaxhon dhe trajton problematikat që shfaqen gjatë ekzekutimit të kontratës dhe që nuk sjellin domosdoshmërisht ndryshime/ modifikime/ përshtatje të saj;
- dh) raporton te titullari i autoritetit/entit kontraktor për shkelje të dispozitave kontraktuale;
- e) administron kërkesat për ndryshime/ modifikime/përshtatje të zbatimit të kontratës dhe sigurohet që këto kërkesa të kalojnë për miratim në strukturat përkatëse, brenda afateve të përcaktuara në kontratë;
- ë) mban korrespondencën e përditësuar me të gjitha dokumentet e shkëmbyera me kontraktorin lidhur me zbatimin e kontratës;
- f) përgatit informacion për çështjet e sipërcituara dhe ia përcjell personit përgjegjës për prokurimin, i cili raporton pranë APP-së

Neni 46

Komunikimet

46.1 Mënyra e komunikimeve midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër dhe Kontraktuesit, është me shkrim dhe në mënyrë elektronike njëherësh. Të gjitha njoftimet të cilat Palët do ti drejtojnë njëra tjetrës të hartohen me shkrim dhe të dorëzohen personalisht në zyrën e protokollit, me poste zyrtare ose poste elektronike duke iu adresuar palëve në mënyrën e mëposhtme:

- a. Për Perfaqësuesin e Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër, adresa e plotë e Institucionit ose adresa e postës elektronike.
- b. Për Përfaqësuesin e Kontraktuesit, adresa e plotë e kontraktuesit ose adresa e postës elektronike, të cilat Palët në çdo kohe ia komunikojnë njëri tjetrit me shkrim.

46.2 Njoftimet do të kenë efekte, me marrjen në dorëzim nga Palët.

Neni 47

Llogaritja e afateve

47. Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike.

Neni 48

Vlefshmëria e kontratës

48.1 Kjo Kontratë do të hartohet në gjashtë kopje origjinale, pesë për Autoritetin Kontraktor dhe një për Kontraktuesin, dhe pasi u lexua dhe u pranua, do të firmoset nga Palët.

48.2 Kjo Kontratë do të quhet e vlefshme duke filluar nga data e nënshkrimit të saj nga të dyja Palët.



KUSHTET E VEÇANTA TE KONTRATES

Kushtet e Veçanta të Kontratës hartohen në përputhje me objektin e Kontratës. Në rast se ka mospërputhje midis KPK dhe KVK do të mbizotërojne Kushtet e veçanta të kontratës.



Neni 1

Përkufizime

1.1 Autoriteti Kontraktor është Bashkia Shkodër, e përfaqësuar nga Kryetar i saj **Z.Benet Beci** në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Shkoder i përfaqësuar ne kete kontrate me Vendim Delegimi nr.325 date 02.10.2023 nga **Z.Onid Bejleri** në cilësinë e Zv/Kryetarit të Bashkisë Shkoder që në vijim do të quhet **Autoriteti Kontraktor**.

1.2 Kontraktues është **“Rej”sh.p.k** e regjistruar me regjistrim fillestar me nr.:CN-005341-09-07 me leje profesionale te shoqerise kodi III.2.B LN-1851-07-2016 date 21.02.2016 me vlefshmeri te lejes pa afat, leshuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomise me seli te shoqerise: Tirane , Zogu i Zi, Qatar Center, kati 2, me NUIS J93711608Q, e perfaqesuar nga Perfaqesuesi Ligjor i shoqerise **Z.Luan Kapri** me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe kompetencë të plotë për të përfaqësuar shoqerine, në të gjitha marrëdhëniet që burojnë prej kësaj kontrate me autoritetin Kontraktor, Bashkia Shkodër për realizimin e objektit të kontratës. Në vijim do të quhet **Kontraktuesi**

Neni 2

Sigurimi i kontratës

- 2.1 Sigurimi i Kontratës në shumën prej *(10% të vlerës së miratuar / korigjuar të ofertës)* do të ofrohet nga Kontraktuesi për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.
- 2.2 Sigurimi i Kontratës do t'i lëshohet ose kthehet, menjëherë Kontraktuesit sipas formularit të mëposhtëm: **Nuk ka.**

Neni 3

Fillimi i kontratës

- 3.1 Zbatimi i Kontratës duhet të filloje në datën që është përcaktuar në nenin 4 të kësaj kontratë.
- 3.2 Specifikimet teknike, preventivi i ofertës fituese, grafiku vjetor i Shërbimeve, janë pjesë integrale e Kontratës dhe detyrime të Kontraktuesit.


Neni 4

Vendndodhja e shërbimeve

4. Shërbimet do të kryhen në të gjithë zonën e Kontratës sipas objektit të kontratës dhe përcaktimeve të preventivit dhe raportit teknik.

Neni 5

Informacion që duhet dhënë nga Autoriteti Kontraktor



5. Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkoder duhet t'i japi Kontraktuesit informacionin dhe dokumentat e mëposhtme:
-Grafikun e shërbimit

Neni 6


Kërkesat e raportimit

6. Gjatë zgjatjes së kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojë raporte për Autoritetin Kontraktor sipas formularit të mëposhtëm: Në përputhje me grafikun e shërbimit.

Neni 7

Kushtet e pagesës

- 7.1 Pagesa për shërbimet, do të bëhet brenda 30 ditëve nga dita e dorëzimit të situacionit mujor të shërbimit, fatures, dhe dokumentacioneve përkatëse.
- 7.2 Autoriteti Kontraktor siguron pagesat për Kontraktuesin për Shërbimet e kryera. Pagesa do të kryhet në bazë të situacionit mujor të paraqitur nga Kontraktuesi me vlerë sipas volumeve të kryera, duke u zbritur masa e volumeve të shërbimit të pakryer si dhe penaltitetet e mundshme të mbajtura për punë të pakryer. Në situacion duhet të perfshihet vlera e T.V.SH.
- 7.3 Administratori i Kontratës bën miratimin e pagesës vetëm në rast se është plotësuar dokumentacioni i mëposhtëm bazuar në procedurën standarte të veprimit për administrimin e shërbimit të pastrimit :
- Raportin mujor përmbledhës të penalteteve për punë të pa kryer nga mbikqyrësit e shërbimit, njësia e monitorimit dhe drejtoria e shërbimeve publike (1 Origjinal) ;
 - Procesverbalin e konstatimit për punë të pa kryer firmosur nga të dy palët: nga mbikqyrësit e shërbimit, njësia e monitorimit të shërbimeve publike dhe drejtoria e shërbimeve publike dhe Kontraktuesi (1 Origjinal);
 - Vendimin për vlerën e shërbimit të pa kryer firmosur nga Autoriteti Kontraktor (1 Origjinal) ;
 - Situacionin mujor të ofrimit të shërbimit firmosur nga të dy palët: nga mbikqyrësit e shërbimit, njësia e monitorimit të shërbimeve publike dhe drejtoria e shërbimeve publike dhe ndjekjes të investimeve në infrastrukturë dhe Kontraktuesi (1 Origjinal);
 - Nese Situacioni i shërbimit dhe fatura perkatëse e tvsh do te jene mujore atehere ato do te mbajne datën duke respektuar radhën e veprimeve sipas procedurës standarte te veprimit. Situacioni hartohet dhe miratohet mbasi të jetë miratuar Proces verbali i konstatimit për punë të pa kryer, proces verbali i marrjes në dorëzim të shërbimit të pastrimit dhe vendimi i Kryetares/it të Bashkisë për punë të pa kryer. Koha e përcaktuar për të përmbushur detyrat deri në njoftimin e operatorit të shërbimit dhe dorëzimi i dokumentacionit nga ana e këtij të fundit është 03-05 të cdo muaji. Në rast mos rakordimi për situacionin e shërbimit mujor ose dokumentacionin mbështetës ku si rrjedhojë sjell vonesa në zbatim të këtij afati, komunikimi midis palëve realizohet ne menyre elektronike ose shkrese dhe afati nis ditën kur të dy palët bien dakord.
 - Faturen/at tatimore të shërbimit, lëshuar nga Kontraktuesi (1 Origjinal) e cila dorezohet ne forme elektronike ;



- g. Proces-verbalin e marrjes në dorëzim të shërbimit të pastrimit nga mbikqyrësit e shërbimit, njësia e monitorimit të shërbimeve publike dhe drejtoria e shërbimeve publike dhe ndjekjes të investimeve në infrastrukturë;
Monedha e pageses do të jete: LEKE.

7.4 Në rast ndryshimi të llogarisë nga ana e Kontraktuesit ky i fundit është i detyruar të njoftojë paraprakisht Autoritetin Kontraktues, Bashkinë Shkodër

Neni 8

Zbritja e garancisë së kontratës

Nëse parashikohet zbritje periodike të garancisë së kontratës ajo kryhet si më poshtë. Nuk parashikohet zbritje e garancisë së Kontratës. Nëse nuk plotësohet, garancia mbetet e pandryshuar.

PËR AUTORITETIN KONTRAKTOR

BASHKIA SHKODËR

Kryetar i Bashkisë

Benet BECI

Perfaqesuar me vendim delegimi

ZV.Kryetar i Bashkisë

Qnid BEJLERI



PËR OPERATORIN EKONOMIK

REJ sh.p.k

Administrator ligjor

Luan KAPRI

